



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria-Vlada-Government*  
*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë*  
*Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry*

**POLITIKA TREGTARE E KOSOVËS**

Gusht, 2009



## PËRMBAJTJA

HYRJE .....	9
1. TREGTIA E JASHTME E KOSOVËS.....	12
1.1 Veçori të tregtisë ndërkombëtare të Kosovës .....	12
1.2 Identifikimi i barrierave në tregtinë e jashtme .....	20
1.3 Tregjet potenciale për prodhimet e Kosovës .....	23
2. REGJIMI TREGTAR DHE LIDHJET INSTITUCIONALE.....	26
2.1 Politika tatimore në kontekstin e politikës tregtare .....	29
2.2 Liberalizimi i Tregtisë.....	32
2.3 Anëtarësimi në OBT.....	36
2.4 Aspektet institucionale dhe regjimi tregtar i Kosovës.....	38
3. DREJTIMET E POLITIKËS TREGTARE TË KOSOVËS.....	42
3.1 Marrëveshjet tregtare.....	45
3.1.1. Qasja në treg.....	45
3.1.2. Korniza rregullative, ligjore dhe institucionale .....	46
3.1.3. Horizonti i politikëbërjes .....	47
3.2 Politikat zhvillimore të lidhura me tregtinë.....	49
3.2.1 Diskutimet sektoriale.....	50
3.2.1.1 Eksportet bujqësore.....	50
3.2.1.2 Eksportet industriale.....	54
3.2.1.3 Çështjet e ndërlidhura.....	58
3.2.2 Krniza kohore e politikave zhvillimore të lidhura me tregtinë .....	59
3.2.2.1 Politikat afatshkurta .....	59
3.2.2.2 Politikat afatmesme .....	60
3.2.2.3 Politikat afatgjata .....	62
3.3 Ndryshimet institucionale për politikë tregtare të orientuar kah zhvillimi .....	64

## **LISTA E TABELAVE**

Tabela 1: Partnerët kryesor tregtar

## **LISTA E TË DHËNAVE**

Figura 1: Bilanci tregtar i Kosovës

Figura 2: Këmbimet tregtare të bazuara në grupet e mallrave

Figura 3: Kategoritë e gjera ekonomike

Figura 4: Tregjet e mëdha të eksportit

## **LISTA E KUTIVE**

Kutia 1: Politika Tregtare dhe Politika Makroekonomike

Kutia 2: Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA)

Kutia 3: Sistemi i Përgjithësuar i Preferencave (GSP)

Kutia 4: Politikat e "Kutisë së Gjelbër" ("Green Box")

## **Parathënie**

Bilanci negativ tregtar mbetet barrë e madhe për ekonominë e Kosovës. MTI në tërësi është e përkushtuar të ndryshojë këtë realitet, dhe të bëjë të mundur avancimin e sektorit eksportues. Mirëpo, MTI është e vetedijshme se hapa të tillë nuk mund të bëhen vetëm. Si rezultat, MTI ka intensifikuar kontaktet me institucionet e tjera relevante, si Ministrinë e vijës, komunitetin e biznesit, donatorët dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm me qëllim të koordinimit të aktiviteteve për të kompletuar këtë proces.

E tërë kjo është përkufizuar në kuadër të Politikës Tregtare të Kosovës, politikë kjo që përbën bazën për hapat e mëtejme institucional në avancimin e sektorit të jashtëm të Kosovës. Ky dokument gjithëpërfshirës propozon masa specifike të cilat targetojnë ngritjen e konkureshmërisë, si në tregun e brendshëm ashtu edhe të jashtëm. Politika Tregtare e Kosovës i vë theksin kryesor liberalizimit të mëtejme të tregtisë. Mirëpo, me qëllim që përfitimet nga liberalizimi i tregtisë të jenë më të lartat dhe më të qëndrueshmet, jo vetëm politika tregtare mirëpo edhe politikat e tjera të lidhura me tregtinë e jashtme duhet të kuptohen dhe të menaxhohen mirë.

Me zyrtarizimin e këtij dokumenti nga Qeveria e Kosovës në fund të gushtit 2009, MTI ka filluar menjëherë me ngritjen e kapaciteteve institucionale për implementimin e rekomandimeve të dala nga Politika Tregtare e Kosovës. Në këtë kontekst, para së gjithash duhet potencuar planet për krijimin e dy grupeve koordinuese për realizimin e procesit të politikës tregtare. E para ka të bëjë me krijimin e një grupi koordinues brenda MTI-së i cili do të i koordinojë aktivitetet e aktorëve brenda MTI që janë të lidhur me politikën tregtare. Ndërsa, grupi i dytë koordinues do të fus nën një ombrellë MTI-


në dhe aktorët e tjerë relevant jashtë MTI-së që janë të lidhur me procesin e politikës tregtare.

Gjithashtu, duhet thënë se koncentrimi i MTI-së në ngritjen e kapaciteteve eksportuese do të vazhdojë edhe në vitin në vijim. Në këtë kontekst, MTI së shpejti do të fillojë me draftimin e Strategjisë për Promovimin e Eksporteve. Kjo e fundit do të ndërtohet mbi bazën e rekomandimeve të dala nga Politika Tregtare e Kosovës, dhe paraqet një plan më të datajizuar të masave për ngritjen e aftësive konkurse të sektorit eksportues si dhe gjetjen e mënyrave për racionalizimin apo zëvendësimin e importeve.

Krejt në fund, duhet falënderuar z. Petrit Gashi dhe z. Mumtaz Keklik për ekspertizën e ofruar në draftimin e këtij dokumenti. Mbështetja e UNDP-së në tërë këtë proces vlerësohet lart. Dokumenti është pasuruar me komentet e ofruara nga pjesëmarrësit në tryezat e organizuara në muajin mars dhe maj 2009, e veçanërisht përfaqësuesit e ECLO dhe Institutin GAP.

Lutfi Zharku

Ministër, MTI



## **HYRJE**

Bilanci negativ tregtar është vetëm një nga problemet ekonomike me të cilin po ballafaqohet Kosova. Institucionet e Kosovës janë të vetëdijshme se ndryshimi i këtij realiteti kërkon qasje gjithëpërfshirëse ekonomike dhe politike dhe reforma në mënyrë që të ndryshohet mjedisi operues në Kosovë, me qëllim të përmirësimit të pozitës konkurruese të Kosovës në tregun botëror. Si rezultat, ato aspirojnë të ndryshojnë dhe plotësojnë politikat ekzistuese ekonomike dhe të përmirësojnë funksionalitetin institucional. Kjo, në një masë të madhe, do të përparonte mjedisin operues në Kosovë. Një përkushtim i tillë është deklaruar qartë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASh, 2008 dhe KASh, 2009), një dokument bazë udhërrëfyes qeveritar mbi ekonominë e Kosovës.

Në një masë të madhe, një mjedis i tillë do të ndihmojë në përcaktimin e nivelit të investimeve, prodhimit dhe eksporteve; dhe, sa më e lartë rritja në këto dimensione aq më e lartë është rritja ekonomike dhe mirëqenia e qytetarëve të Kosovës. Për sa i përket nivelit të investimeve, ky mjedis përcakton fluksin e investimeve të huaja, të cilat janë mekanizmi potencial kryesor për revitalizimin e ekonomisë së Kosovës dhe, si rrjedhojë, forcimin e sektorit të eksportit.

Kosova është e përkushtuar për liberalizimin e tregtisë. Pjesëmarrja në mekanizmat rajonal dhe më gjerë për lehtësimin e tregtisë ka qenë një nga objektivat kryesore të politikave të institucioneve të Kosovës. Zgjerimi i tregtisë në Kosovë përmes liberalizimit tregtisë kërkon që tre aspekte të

jenë në vend: racionalizimi dhe zëvendësimi i importit, lehtësimi i tregtisë, dhe promovimi i eksporteve. Kjo është strategjia e integruar e eksportit e UNCTAD-it (Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim) e cila i jep rëndësi të barabartë konkurrencës në tregun e brendshëm dhe konkurrencës në tregun e huaj. Megjithatë, liberalizimi i tregtisë, vetëm si i tillë nuk është i mjaftueshëm për rritje të aktivitetit eksportues. Ka disa arsye për këtë: së pari, politikat tregtare duhet të formulohen, zbatohen dhe vlerësohen në mënyrë të tillë, që vendosin si prioritet zhvillimin në vend të rezultateve të tregtisë ndërkombëtare. Së dyti, në mënyrë që përfitimet nga liberalizimi i tregtisë të jenë maksimale dhe më të qëndrueshme, jo vetëm politikat tregtare, por edhe politikat zhvillimore të lidhura me tregtinë duhet të kuptohen dhe të menaxhohen mirë. Së fundi, tregtia është një koncept multidimensional që ndikon në pothuajse të gjitha fushat e jetës ekonomike dhe sociale. Prandaj, ekziston nevoja për përmirësim në cilësinë institucionale, përfshirë bashkëpunimin dhe koherencën midis të gjithë aktorëve relevantë që përbëjnë sistemin e tregtisë në Kosovë. Si rrjedhojë, fushat që kërkojnë një reformë sinjifikante përfshijnë:

1. Liberalizimin e tregtisë (përfshirë këtu anëtarësimin në OBT) do të bëhet gradualisht dhe sipas një plani të detajuar;
2. Politikat e lidhura me tregtinë do të identifikohen edhe më tej, si dhe specifikat e politikave dhe modalitetet e zbatimit të tyre;
3. Ndryshimi institucional si brenda MTI-se ashtu edhe brenda të gjithë sistemit të tregtisë do të arrihet në kontekstin e një plani të vazhdueshëm të zhvillimit të kapaciteteve.

Partnerët tanë zhvillimor (që d.m.th. donatorët) do të identifikohen dhe do të ju afrohem për të arritur këto tri objektiva kryesore dhe përfundimet në një periudhë të caktuar kohore.

Ky dokument është një vazhdimësi e dokumentit të vitit 2004 dhe disa dokumenteve të mëparshme qeveritare mbi regjimin tregtar të Kosovës. Duke u bazuar në faktin se situata në bilancin tregtar mbetet e pandryshuar, institucionet e Kosovës (në veçanti, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ) janë të përkushtuara për të sforcuar rekomandimet e dhëna në dokumentin e mëparshëm, si dhe të ndër marrin hapa shtesë që synojnë në promovimin e sektorit të eksportit. Plotësimet e paraqitura në dokument marrin në konsideratë ndryshimet politike si rezultat i pavarësisë së Kosovës, e cila ka ndryshuar kontekstin dhe pozitën politike të Kosovës në arenën ndërkombëtare, e cila gjithashtu është e reflektuar edhe në pozitën ekonomike të Kosovës në lidhje me shtetet tjera dhe institucionet ekonomike ndërkombëtare. Ky dokument është në përputhje të plotë me KASH dhe me politikat e tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, të tilla si politikat në lidhje me promovimin e biznesit, politikat energjetike dhe industriale, etj. Dizajnimi i kësaj politike është trajtuar në kontekstin e procesit të integritimit në BE. Ndryshimet në këtë dokument gjithashtu marrin në konsideratë sinjalet nga komuniteti i biznesit në Kosovë dhe nga palët tjera ekonomike të interesuara.

Ky dokument është hartuar bashkërisht nga MTI-ja dhe ekspertë të kësaj fushe. Kontribuesi më i madh nga ana e MTI-

së është Departamenti i Tregtisë. Ekspertiza e jashtme përbëhet nga një konsulent vendor dhe ndërkombëtar të mbështetur bashkërisht nga MTI-ja dhe zyra e UNDP-së në Kosovë. Dokumenti është pasuruar në masë të madhe me komentet e palëve të interesuara ekonomike ndërkombëtare dhe lokale. Ky punim është i ndarë në tri pjesë kryesore: pjesa e parë është e përqendruar në trendët aktuale të tregtisë së jashtme të Kosovës. Ky seksion diskuton shkurtimisht barrierat, përparësitë komparative dhe tregjet potenciale për produktet e Kosovës. Pjesa e dytë analizon regjimin aktual tregtar dhe dimensionet e mjedisit institucional të cilat janë të rëndësishme për promovimin e eksportit. Pjesa e fundit përqendrohet në drejtimet specifike që Kosova duhet të ndër marrë në lidhje me politikën tregtare, duke vendosur një vizion të qartë për të rritur potencialin e sektorit të eksportit në Kosovë.

## **1. TREGTIA E JASHTME E KOSOVËS**


Kosova është një ekonomi e hapur; pjesëmarrja e eksportit dhe importit në BPV (ose faktori i hapjes së tregut, d.m.th. eksport + import / BPV) ishte gati 0,6 në vitin 2008 (për vitet e mëparshme situata nuk ndryshon ndjeshëm). Tregtia e jashtme është e dominuar nga importet; niveli i eksportit është i vogël duke rezultuar në deficit të lartë tregtar. Kjo pjesë e dokumentit do të përqendrohet në disa aspekte të veçanta të tregtisë ndërkombëtare në periudhën e pas-luftës. Fillimisht, do të ofrohet një diskutim mbi rrjedhat e tregtisë së Kosovës. Pastaj, diskutimi do të përqendrohet në barrierat dhe kufizimet e tjera me të cilat ballafaqohet sektori i eksportit, si rezultat i të cilave, në përgjithësi, ekonomia e Kosovës nuk është duke operuar me tërë potencialin e saj, dhe në veçanti sektori i eksportit. Së fundi, ky seksion do të elaborojë përparësitë komparative (kryesisht ato statike) si dhe tregjet e huaja potenciale për produktet Kosovare.

### **1.1 Veçori të tregtisë ndërkombëtare të Kosovës**

Ekonomia Kosovare ka shënuar rritje relativisht të ultë që nga 1999 (megjithatë, duhet pasur në mendje shkallën shumë të lartë të rritjes në vitin e parë të periudhës pas-luftës, edhe pse, nga një bazë shumë e ulët). Edhe pse, gjatë kësaj periudhe, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm makroekonomik për ringjalljen e ekonomisë Kosovare, ende mbeten shumë sfida. Një tregues i tillë është bilanci i lartë negativ tregtar, i

vazhdueshëm që nga fundi i vitit 1999 (figura 1). Kosova është tejet e varur nga importet (importet përbëjnë rreth 50% të BPV-së) dhe trendet tregojnë se në një afat të shkurtër është vështirë të priten ndryshime të mëdha. Sipas KASH-it (2008, f. 11) pasi që "Kosova është një ekonomi e euroizuar, ajo mund të përmirësojë bilancin tregtar vetëm përmes zhvlerësimit real valutor, e cila mund të arrihet me çmime relative më të ulëta me partnerët tregtare

**Figura 1: Bilanci tregtar i Kosovës (2001- 2008; në mil. €)**



*Burimi:* Enti i Statistikave i Kosovës, 2009

Kjo mund të vijë nga reduktimet e pagave dhe përmirësimet në efikasitetin e brendshëm".

Eksportet në periudhën e pas-luftës kanë shënuar një rritje impresive (mbi 60% në mesatarisht në vit për periudhën 2001-

2008), edhe pse, praktikisht nga një bazë zero e eksportit<sup>1</sup>. Në anën tjetër, për të njëjtën periudhë, importet kanë shënuar rritje të konsiderueshme prej 15% mesatarisht në vit. Në 2008, importet arritën shifrën prej gati 2 miliard €, kurse eksporti pak nën 200 milion €. Edhe pse mbulimi i importit është ende shumë i ulët, ai është rritur në mënyrë të qëndrueshme që nga viti 2001, duke arritur tregues dyshifror në 2007 dhe 2008, respektivisht 10,5% dhe 10,2% (ESK, 2009). Një pasqyrë më premtuese do të paraqitet në qoftë se merret në konsideratë edhe i ashtuquajtimi eksporti "virtual" - i cili përfshin konsumin e pranisë ndërko-mbëtare në Kosovë - sipas të cilit eksporti mbulon 20 për qind të importeve (në llogaritë kombëtare, kjo pjesë e eksportit konsiderohet si "eksport i shërbimeve").


Në lidhje me strukturën e eksporteve, ato janë kryesisht në formën e lëndës së parë dhe produkteve të papërfunduara (shih Figurën 2). Eksportet janë të dominuara nga mbeturinat metalike si dhe produktet minerale të cilat gjatë periudhës 2002-2008 kanë mbuluar, mesatarisht, rreth 60% të totalit të eksportit. Nga 2002 deri në vitin 2008 Kosova eksportoiti metale bazë dhe artikujt të tjerë të ngjashëm me mbi 300 milion €. Këto mallra janë në formën e mbeturinave metalike, të cilat kryesisht janë shitur në Maqedoni, Greqi, Itali dhe vende të tjera. Mbeturinat janë kryesisht në formën e hekurit dhe çelikut, bakrit, zinkut, dhe metaleve të tjera. Një tjetër

---

<sup>1</sup> Shënim kujdesi: Kosova ka mungesë të të dhënave të cilësisë së mirë; kështu, rezultatet e diskutimit do të duhen të merren me një shkallë të kujdesit. Edhe pse të dhëna për sektorin e huaj janë konsideruar si të cilësisë mirë nga palët e ndryshme të interesit, gjatë hartimit të këtij dokumenti autorët kanë hasur në jo konsistencë të të dhënave të gjeneruara nga agjenci të ndryshme. Ka një konsensus të gjerë se të dhënat nga Enti Statistikor i Kosovës janë më të besueshme, prandaj, ne kemi përdorur të dhënat e tyre.

komponent e kësaj kategorie është eksporti i nikelit dhe hekurit që ka shënuar një rritje të eksporteve për rreth 70% nga 2007 në 2008. Produktet minerale përbëjnë një tjetër komponent të rëndësishëm të eksporteve të Kosovës. Për periudhën 2002-2008, kjo kategori e fudit ka krijuar

**Figura 2: Këmbimet tregtare bazuar në grupet e mallrave, % e totalit 2002-2008**



Shënim:

- a - Metalet bazë dhe artikujt e ngjashëm
- b - Produktet minerale
- c - Ushqimet e përgatitura, perimet, pijet dhe duhani
- d - Makinaria dhe pajisjet
- e - Gëzofët, lëkurat dhe materiale të ngjashme

Shënim:

- a - Ushqimet e përgatitura, perimet, pijet dhe duhani
- b - Produktet minerale
- c - Makinaria dhe pajisjet
- d - Metalet bazë dhe artikujt e ngjashëm
- e - Prodhimet kimike dhe industria e legurave

*Burimi:* Enti i Statistikave të Kosovës, 2009


mesatarisht rreth 17% të totalit të produkteve Kosovare (duke filluar nga rreth 5% në vitin 2002 në mbi 35% në vitin 2007). Një tjetër komponent i rëndësishëm eksporti është makinaria dhe pajisjet, një mall që ka treguar trend pozitiv në strukturën e eksporteve që nga viti 2002. Viti 2007 shënon nivelin më të lartë të eksporteve të këtij malli, me mbi 20 milion € ose 13% të totalit. Prodhimet e ushqimit dhe pijeve mbulojnë një

përqindje të rëndësishme të eksportit (mesatarisht rreth 12% nga viti 2002 deri 2008). Në këtë kontekst, duhet theksuar se vera është eksportuar në Gjermani dhe në disa vende të rajonit. Përveç kësaj, lëkurë dhe produkte të ngjashme si dhe industria e plastikës kanë një pjesëmarrje të rëndësishme në strukturën e eksporteve të Kosovës. Mallra më pak të rëndësishme në aspektet eksportuese janë produkte kimike dhe të ngjashme, gur dekorativ, produktet e celulozës dhe kafshët e gjalla.

Nga ana tjetër, në vitet e pas-luftës, mallrat e konsumit përbënin pjesën më të madhe të importeve të Kosovës (Figura 2). Prodhimet e ushqimit kanë pasur pozitën dominuese në strukturën e importeve që nga viti 1999, duke mbuluar mesatarisht 22% të totalit (për periudhën 2002 - 2008). Kjo përqindje ishte edhe më e madhe në vitet e para pas luftës, që është e kuptueshme duke pasur parasysh nevojat e popullatës pas luftës dhe kolapsit të ekonomisë së Kosovës. Megjithatë, duhet të veçohet rënia konstante e importeve të ushqimit në strukturën e importeve (nga 26% në vitin 2002, në 19% në vitin 2008). Në përgjithësi, që nga viti 2002 struktura e importeve ka ndryshuar vazhdimisht.

Produktet minerale kanë shënuar rritje të konsiderueshme që nga viti 2002, nga 14,5% në 21% në vitin 2008. Një rritje është shënuar në kategorinë e makinerisë, pajimeve, dhe pajisjeve elektrike, të cilat përbëjnë grupin e tretë më të madh e mallrave të importuara në Kosovë. Këto ndryshime janë shënuar në raportin e fundit të Bilancit të Pagesave të përgatitur nga Banka Qendrore e Kosovës (shih figurën 3).

**Figura 3: Kategoritë e gjëra ekonomike , % e totalit të importit**



Burimi: BQK (2009)

Ky ndryshim cilësor në strukturën e importeve është tregues i trendëve të reja të ekonomisë kosovare për ringjallje dhe forcimin e sektorit prodhues. Ajo tregon se ka disa zëvendësime të importit në vazhdimësi. Në fakt, ai tregon një tendencë të ngritjes së ekonomisë në aspektin e nivelit më të lartë të konkurrueshmërisë.

Është dhënë një numër i mallrave të tjera që përbëjnë një pjesë të rëndësishme të importeve të Kosovës. Edhe pse jo aq e rëndësishme sa në rastin e eksporteve, metalet bazë dhe artikuj të ngjashëm përbëjnë një pjesë të rëndësishme të totalit të importeve. Ngjashëm me produktet minerale është grupi i makinerisë dhe pajimeve; pjesëmarrja e këtij malli ka pësuar një rritje sinjifikante të qëndrueshme në strukturën e importeve, nga mbi 6% në vitin 2002 në mbi 9% në vitin 2008. Një tjetër komponent i rëndësishëm në strukturën e importeve janë produktet kimike, të cilat kanë mbuluar mesatarisht mbi 7% të totalit të importeve të Kosovës nga viti 2002 deri më

2008. Për më tepër, automjetet e transportit, kafshë të gjalla, industria e plastikës, dhe produktet e drurit janë disa nga mallrat e rëndësishëm në strukturën e importit të Kosovës.

Struktura e importit dhe eksportit e bazuar në partnerët tregtar është paraqitur në tabelën e mëposhtme. BE dhe vendet anëtare të CEFTA-s janë partnerët kryesorë të Kosovës në tregtinë e jashtme. Mbi  $\frac{3}{4}$  e importeve dhe eksporteve janë realizuar me këto grupe të vendeve gjatë periudhës 2003 - 2008 (situatë e ngjashme është edhe para 2003). Për sa i përket tregtisë me vendet e CEFTA-s, struktura tregon se marrëdhëniet me ish-republikat jugosllave mbeten mjaftë të ngushta. Gjatë periudhës në shqyrtim, Maqedonia dhe Serbia ishin partnerët kryesorë rajonal që mbulojnë rreth 1/3 të eksportit dhe importit të Kosovës, respektivisht. Në vitin 2007 dhe 2008, siç tregojnë Figura 4 dhe 5, importet nga këto vende mbulonin 30% gjegjësisht 29% të totalit të importeve; eksporti nga Kosova në këto vende ishte më i ulët se mesatarja, përkatësisht 22% dhe 15%. Megjithatë, eksporti në Serbi duket se nuk do të qëndrojë në 2009 pasi që Serbia është duke bllokuar produktet Kosovare të hyjnë në tregun e saj<sup>2</sup>. Vendet tjera në rajon kanë pjesëmarrje më të ulët; rëndësia e Shqipërisë si një partner tregtar është në rritje sidomos pas hyrjes në fuqi të MTL 2004. Eksporti në Shqipëri ka shënuar një rritje të konsiderueshme: nga 3,2% të totalit të eksporteve të Kosovës në vitin 2003 në 12,6% dhe 10,7% në vitin 2007 dhe 2008, respektivisht. Vendet tjera të rajonit nuk kanë pjesëmarrje të rëndësishme në rrjedhat tregtare me Kosovën.

---


<sup>2</sup> Serbia dhe Bosnja e Hercegovina nuk kanë njohur vulat e doganave të Republikës së Kosovës.


**Tabela 1: Partnerët kryesor tregtar (në %)**

		2003	2004	2005	2006	2007	2008
<b>BE</b>	<i>Eksporti</i>	41.7	29.3	38.8	38.2	42.6	47.8
	<i>Importi</i>	28.4	39.9	38.0	34.8	35.2	36.2
<b>CEFTA</b>	<i>Eksporti</i>	51.3	41.6	53.0	46.7	41.3	30.9
	<i>Importi</i>	45.6	34.7	38.0	41.1	36.7	37.5
<b>Të tjerë</b>	<i>Eksporti</i>	7.0	29.1	8.2	15.1	16.1	21.3
	<i>Importi</i>	26.0	25.4	24.0	24.1	28.1	26.2

Burimi: Enti i Statistikave i Kosovës, 2009

Përsa i përket rrjedhave tregtare me vendet e BE-së, Italia ka absorbuar pjesën më të madhe të eksporteve të Kosovës, duke mbuluar mesatarisht rreth 30% të totalit të eksporteve të Kosovës në vendet e BE-së nga 2003 deri në vitin 2008.

**Figura 4: Tregjet kryesore exportuese %**

**Figura 5: Partnerët kryesorë importues %**

*Burimi:* Enti i Statistikave i Kosovës, 2009

Italia është e ndjekur nga Gjermania dhe Greqia. Të njëjtat vende janë edhe burimi kryesor i importeve (për të njëjtën periudhë si më sipër) megjithatë, me një renditje të ndryshme; Gjermania është eksportuesi më i madh i BE-së në Kosovë, e ndjekur nga Greqia dhe Italia.

Në kategorinë e vendeve "tjera" (shih Tabelën 1), partnerët kryesorë janë Turqia dhe Zvicra si destinacione të eksportit, ndërsa Kina dhe Turqia për sa i përket importeve. Megjithatë, 2008 ka shënuar një ndryshim të rëndësishëm në aspektin e destinacionit të eksportit (shih figurën 4). Belgjika dhe India janë bërë dy partnerët më të mëdhenj të eksportit të Kosovës. Kjo është për shkak të aktiviteteve të kompanive eksportuese të metaleve bazë (hekurit dhe nikelit). Belgjika dhe India kanë absorbuar mbi 25% të totalit të eksporteve të Kosovës në 2008. Megjithatë, si duket ky trend nuk do të mund të qëndrojë pasi që ka indikacione se ky sektor është goditur shumë nga kriza e tanishme financiare.

Të dhënat tregojnë se vetëm në janar 2009 Kosova ka

eksportuar 1.3 milion € në Indi, ndërsa nuk ka patur asnjë eksport në shkurt; eksportet në Belgjikë në dy muajt e parë të vitit 2009 janë zero. Në 2008, në këta dy muaj Kosova ka eksportuar në këto dy vende 9.6 milion €.

## **1.2 Identifikimi i barrierave në tregtinë e jashtme**

Arsyet për performancën e varfër të sektorit të eksportit në Kosovë janë të shumta dhe të gjitha natyrave, si politike, historike dhe ekonomike.<sup>3</sup> Shumica e këtyre mangësive janë të lidhura me njëra-tjetrën; për shembull, për një periudhë të gjatë statusi i pazgjidhur politik ka qenë një pengesë për zhvillimin e Kosovës. Në këtë kontekst, ka disa faktorë të cilët duhet të specifikohen dhe të cilat kanë pasur një ndikim në zhvillimin e sektorit të ndërmarrjeve, dhe veçanërisht në sektorin e eksportit: Kosova e pas luftës ka trashëguar industrinë dhe kompanitë pothuajse në kolaps total si rezultat i shkatërrimit dhe vjedhjes; vonesat dhe shumë komplikime në procesin e privatizimit kanë bërë edhe më të vështirë që ato të ringjallen. Në anën tjetër, për shumë vite Kosova nuk ishte pjesë e nismave rajonale që synonin liberalizimin e tregtisë, kryesisht për shkak të statusit të pazgjidhur politik. Për më tepër, niveli i Investimeve të Huaja Direkte (IHD) nuk ka qenë i kënaqshëm (i parëndësishëm menjëherë pas vitit 1999, megjithatë, relativisht i lartë që nga viti 2005), një faktor shumë i rëndësishëm në shumë vende në tranzicion për ngjalljen e ekonomisë dhe veçanërisht sektorin e tyre të eksportit.

---

<sup>3</sup> Intenca e jonë në këtë dokument nuk është të identifikojmë në çfarëdo mënyre të gjitha pengesat në të bërit biznes në Kosovën e pas luftës. Qëllimi i kësaj pjese është të identifikojë kontekstin aktual në të cilën është realizuar dhe tani është duke u realizuar biznesi në Kosovë si dhe implikimet e këtyre pengesave në aktivitetet dhe eksportet e ndërmarrjeve.

Ekonomia joformale është gjithashtu një dimension të cilin duhet përmendur.<sup>4</sup> Në fund, duhet të potencojmë furnizimin jo të rregullt me energji elektrike si dhe infrastrukturën e kufizuar rrugore si pjesë e realitetit të Kosovës.

Këto probleme, të cilat në thelb kanë të bëjnë me realitetin specifik të Kosovës së pas-luftës, në konstelacion me institucionet dhe politikat në ndërtim, kanë penguar zhvillimin e sektorit privat, sektor i cili duhet të jetë në gjendje të bartë barrën kryesore për eksport. Aktualisht, sektori privat është pothuajse tërësisht i përbërë nga Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (NVM) jo shumë efikase. Pothuajse inekzistenca totale e ndërmarrjeve të mëdha në strukturën e ndërmarrjeve në Kosovë ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në nivelin e ulët të eksportit pasi që në shumicën e vendeve ato janë ndërmarrjet të cilat janë shumë aktive në aktivitete eksportuese, si rezultat i potencialit dhe resurseve të tyre. Në anën tjetër, mungesa e tyre në mënyrë specifike ka ndikuar edhe në zhvillimin e NVM-ve sepse ndërmarrjet e mëdha janë ato nga të cilat rezulton një përqindje e madhe e kërkesës për produktet dhe shërbimet e NVM-ve. Ky fakt ka ndikuar që një pjesë e madhe e NVM-ve mos të kalojnë ciklin jetësor dinamik të zhvillimit dhe rritjes në ndërmarrje të mëdha, të cilat pastaj do të ishin një burim shtesë potencial i eksportit.

Në kontekstin e pengesave që kanë të bëjnë me politikat ekonomike dhe institucionet, duhet diskutuar edhe politikën tatimore. Kjo e fundit vazhdimisht ka shkaktuar pakënaqësi në

---

<sup>4</sup> Në bazë të EC (2008) ekonomia joformale në Kosovë llogaritet sipas disa vlerësimeve 30% të BPV-së në Kosovë, apo 700 milion € në vit (The European Commission Liaison Office to Kosovo press release of 27 August 2008)

mesin e komunitetit të biznesit, edhe pse shpesh faktet nuk kanë qenë të argumentuara (shih diskutimin në vijim). Sistemi financiar gjithashtu ka tërhequr vëmendjen si një pengesë për zhvillimin e biznesit në Kosovë. Në kontekst të zhvillimit të ndërmarrjeve, dhe e lidhur me sistemin financiar, ka qenë zbatimi i ligjit (në veçanti zbatimi i kontratave) i cili konsiderohet si pengesë kryesore. Pastaj, në kontekstin e sektorit të eksportit, duhet theksuar shërbimin doganor në ndërtim, procedurat komplekse të reimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH)<sup>5</sup>, institucionet jo mjaft të zhvilluara për sigurimin e cilësisë, dhe pengesa të tjera.

Përveç kësaj, rrjedhja e eksportit të Kosovës është penguar nga masat dhe instrumentet e aplikuara në politikat tregtare të vendeve të tjera; eksportuesit Kosovar ishin detyruar të ndeshen me ngarkesa tarifore (për shembull, taksat transit), si dhe me ngarkesat jo-tarifore (të tilla si subvencionet). Veçanërisht këto të dytë kanë qenë prevalente, dhe kanë marrë forma nga më të ndryshmet.

Së fundi, edhe kompanitë e mbajnë një pjesë të përgjegjësisë për performancën e dobët të sektorit të tregtisë së jashtme në Kosovë. Disa probleme tejet specifike që ndikojnë në pozitën konkurruese të firmës në tregun e huaj janë si vijon: mungesa e strategjisë për të bërë biznes ndërkombëtar, qasje inovative si në procesin e prodhimit dhe atë të punës (përmes të cilit ata do të arrinin diferencimin e produktit dhe rritjen e efektivitetit të strukturës organizative të firmës), numër i kufizuar i lidhjeve me partnerët e huaj, mundësitë e kufizuara për të hyrë në

---

<sup>5</sup> Amandamenti i Ligjit mbi TVSh-në (që do të aprovohet së shpejti) thjeshtëson në masë të madhe procedurat e reimbursimit të TVSh-së.

rrjetet e bizneseve (në të cilat kompanitë e ndryshme do të ishin përgjegjëse për aktivitete të ndryshme nga prodhimi e deri të vendosja e produktit në treg), dhe disa aspekte të tjera.

### **1.3 Tregjet potenciale për prodhimet e Kosovës**

Sipas KASH-it (2009, f. 12), për periudhën e parashikuar, eksportet e Kosovës deri në 2012 pritet që të rriten për afër 50% krahasuar me 2008 (një rritje progresive me mbi 10% në vit është projektuar). Megjithatë, në KASH nuk thuhet në mënyrë eksplicite se cilat produkte ose industri do të bartin barrën kryesore të këtij eksporti shtesë dhe në të cilat tregje këto eksporte mund të plasohen. Prandaj, diskutimi do të përqendrohet në industrinë potenciale të Kosovës për eksport duke analizuar përparësitë komparative të Kosovës, dhe pastaj do të vazhdojmë me tregjet potenciale për produktet Kosovare.

Bazuar në të dhënat zyrtare është e vështirë për të identifikuar qartë sektorët apo industrinë në të cilat potencialisht Kosova ka përparësi komparative. Struktura e eksporteve në dhjetë vitet e fundit nuk jep një pasqyrë të qartë nga e cila do të mund të nxjerrim përfundime të caktuara lidhur me këtë çështje. Për më tepër, të dhënat e para-luftës në Kosovë për rrjedhat e tregtisë nuk tregojnë shumë. Lidhur me përparësitë krahasuese të Kosovës disa indikacione mund të nxirren në bazë të faktorëve potencial të prodhimit që ka Kosova, do të thotë, burimet natyrore dhe kapitalin njerëzor. Ashtu si në Politika Tregtare e Kosovës 2004, industrinë ekstraktuese dhe sektori i energjisë mbeten industrinë me përparësi të dukshme komparative. Kosova ka një përparësi të dukshme në prodhimin e energjisë

elektrike, duke pasur parasysh kërkesën e madhe për energji në rajon dhe më gjerë si dhe koston e ulët nga e cila energjia në bazë të linjtit do të mund të prodhohet në Kosovë. Burimet tjera minerale kanë një potencial të dukshëm sidomos duke pasur parasysh trendin e rritjes së çmimeve në tregun botëror për këto mallra.

Në këtë kontekst, bujqësia duhet gjithashtu të përmendet, duke patur parasysh cilësinë e tokës se punueshme dhe përqindjen e madhe të forcës punëtore ne dispozicion në Kosovë. Megjithatë, ky sektor ka pasur vështirësi të mëdha pasi që ai ka qenë i subvencionuar në vendet e tjera, përderisa Kosova nuk ka qenë në gjendje të aplikojë ndonjë masë të rëndësishme për rritjen e sektorit. Megjithatë, ekonomia e Kosovës, dhe si rezultat sektori i eksportit, nuk mund të mbështetet plotësisht në industrinë ekstraktive e as në bujqësi. Kosova duhet të zgjedh të shfrytëzojë burime të tjera të përparësive komparative dhe duhet të gjejë mekanizma tjera të tregut për të zgjeruar aktivitetet e eksportit. Në këtë kontekst, diskutimi duhet të zgjerohet mbi përparësitë dinamike krahasuese të Kosovës. Industria nxjerrëse dhe sektori i energjisë janë në esencë përparësi krahasuese statike pasi ato përbëjnë thjesht një rialokim të resurseve të brendshme. Nga ana tjetër, duhet gjithashtu të merret në konsideratë fakti se burimet e krijuara shtesë ose burimet që vihen në dispozicion përmes importit mund të sigurojnë bazën për krijimin e përparësive krahasuese të reja. Ky është një proces afat-gjatë; Qeveria e Kosovës është e përkushtuar të miratoj politikat të cilat gjatë kohës do të promovojnë mundësitë e reja për ndryshim, pasiqë ndryshimet dinamike të

përparësive krahasuese në industri kërkojnë vite. Mirëpo, industrinë potenciale për këtë proces për momentin është e vështirë të identifikohen në Kosovë; në rastin më të mirë, Qeveria e Kosovës do të shqyrtojë mënyrat e gjenerimit të përparësive krahasuese veçanërisht përmes mobilizimit të kapitalit njerëzor, apo të potencialeve të tjera që ka. Megjithatë, zgjedhja e industrisë në të cilën politikat e Qeverisë do të drejtohen duhet të ketë për bazë nivelin më të lartë të produktivitetit, lidhjet të forta me pjesën tjetër të ekonomisë, dhe duhet të jetë njëra nga industrinë për të cilën konkurrueshmëria e ardhme është e rëndësishme.

Për sa i përket tregjeve potenciale, mund të thuhet me siguri se potenciali më i madh mbetet ai i tregut të BE-së. Të dhënat e partnerëve tregtarë të Kosovës për vitet e fundit tregojnë një tendencë në rritje të bizneseve kosovare për t'u orientuar drejt tregut të BE-së. Një tendencë e tillë është vërejtur edhe tek vendet e rajonit. Zhvillimi i marrëdhënieve me BE-në është kritik për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Për shkak të madhësisë dhe potencialit absorbues të BE-së, Kosova do të përfitonte nga rritja e kërkesës për produktet e saja në vendet e BE-së dhe investimet e mundshme që potencialisht mund të ndodhin. Më pas, investimet do të rezultojnë në transferimin e njohurisë dhe inovacioneve që do të kishin efekte të përsheptuara dhe multiplikuese në ekonominë e Kosovës.

Megjithatë, duke pohuar këtë, në asnjë mënyrë nuk duhet minimizuar rëndësinë e tregut rajonal. Faktorët që kanë të bëjnë me gjuhën, kulturën dhe historinë e përbashkët do të mbeten të rëndësishme për shkëmbimet tregtare midis disa vendeve të rajonit të Ballkanit. Pastaj, shpenzimet e ulëta të

transportit, pjesëmarrja e përbashkët në iniciativat e integritit, dhe qëllimi i përbashkët për të iu bashkuar BE-së, janë faktorët që duhet të merren parasysh në marrëdhëniet e ardhshme tregtare të Kosovës me vendet e rajonit.

Në këtë kontekst, jashtë zonës së BE-së dhe CEFTA-s, treg i rëndësishëm dhe me potencial të rritjes do të mbetet tregu Turk.

## 2. REGJIMI TREGTAR DHE LIDHJET INSTITUCIONALE<sup>6</sup>

Tregtia e jashtme konsiderohet të jetë një prej instrumenteve kryesore të rritjes në Kosovë. Për këtë arsye, politika tregtare mbetet një nga aspektet kryesore të politikës së përgjithshme ekonomike (për lidhjen ndërmjet politikës tregtare dhe politikave makroekonomike shih Kutinë 1). Kosova ka një regjim tregtar i cili është i thjeshtë dhe lehtë i menaxhueshëm, transparent dhe jo-diskriminues. Të gjitha këtotribute janë të rëndësishme për promovimin e një sektori konkurrues eksporti. Më tej në këtë seksion do të diskutojmë në detaje mekanizmat e regjimit tregtar të Kosovës. Në seksionin pas këtij, do të ofrojmë sugjerimet për drejtimet që politika tregtare e Kosovës duhet të ndjekë në vitet e ardhshme.

### *Kutia 1: Politika Tregtare dhe Politika Makroekonomike*

#### **1. Ndikimi i Politikës Tregtare në Politikën Makroekonomike**

*Ndryshimet në politikën tregtare ndryshojnë përmbajtjen e zhvillimit të politikave makroekonomike. Mënyra më e dukshme e kësaj është nëpërmjet ndikimit të politikës tregtare në politikën fiskale, e cila është mjete kryesor për shtetet që të udhëheqin politika efektive sociale dhe industriale. Politika tregtare prek të*

<sup>6</sup> Një pjesë e informacionit në këtë seksion është i bazuar në Politika Tregtare e Kosovës, 2004.

*dyja anët e buxhetit kombëtar, si të hyrat ashtu edhe shpenzimet.*

*Në anën e të hyrave ndikimi është i drejtpërdrejtë. Reduktimi i tarifave, së paku në vendet me se paku të zhvilluara dhe ato me të hyra mbi mesataren ka tendencë të zvogëlojë, në vend se të rrite, të ardhurat e qeverisë (Rao 1999<sup>7</sup>; Khattry and Rao, 2001<sup>8</sup>).*

*Kjo do të thotë se ekziston një marrëdhënie pozitive midis të hyrave tregtare (në fakt të hyrat totale të qeverisë, sipas hulumtimit të fundit) dhe të hyrave nga tarifat. Përkrahësit e liberalizimit të shpejtë të tregtisë argumentojnë se pasi që vëllimi i tregtisë rritet totali i të hyrave nga tatimet e lidhura me tregtinë në fakt rritet, edhe në qoftë se tarifat janë reduktuar. Për fat të keq, të dhënat të paktën në nivel ndër shtetëror nuk e mbështesin këtë pohim. Ndërsa duhen hulumtime serioze për të bërë, në shumë vende në zhvillim dhe më pak të zhvilluara kjo marrëdhënie është pozitive. Kamboxha, për shembull, ka liberalizuar llogarinë e vet rrjedhëse gjatë dekadës së fundit, edhe pse në mënyrë graduale. Pjesëmarrja e të hyrave tregtare në të hyrat totale të qeverisë në gjysmën e fundit të dekadës është reduktuar nga diku rreth 50% sa ishin në gjysmën e dytë të viteve 1990, në aktualisht 24%.*

*Prandaj, liberalizimi i tarifave dhe llojet e tjera të politikave të liberalizimit të tregtisë, me siguri kanë për të vënë një barrë financiare shtesë mbi buxhetin e qeverisë, duke kufizuar aftësinë e saj për të udhëhequr politika kuptimplote sociale dhe ekonomike, të cilat përndryshe do të ndihmonin tregtinë, rritjen e mëtejshme,*

---

7 Khattry, B. dhe Rao, M. (2002), Fiskal *Faux Pas*?: An Analysis of the Revenue Implications of Trade Liberalization ,

*World Development* 30(8): 1431-144

8 Rao, J. Mohan 1999, Openness, Poverty and Equality, Background Paper, *Human Development Report* 1999. UNDP: New York.

*dhe zhvillimin njerëzor.*

*Te hyrat e qeverisë janë gjithashtu të prekura nga kostoja e zbatimit të marrëveshjeve të OBT-së. Për shembull, sipas Michael Finger kostoja e zbatimit të tre marrëveshjeve të OBT-së, vlerësimin doganor, masat sanitare dhe fito-sanitare (SFS), dhe të drejtat e pronës intelektuale (TRIPs) i kushtojnë një vendi tipik në zhvillim \$ 150 milion. Kjo është e barabartë me një buxhet vjetor të shumicës së vendeve më së paku të zhvilluara (Finger and Schuler, 1999<sup>9</sup>; Rodrik 2001<sup>10</sup>).*

*Udhëheqja e politikës së qëndrueshme sociale dhe industriale është një biznes i kushtueshëm. Skemat e politikës industriale, të tilla si skemat e kredive selektive, skemat e trajnimit, mbështetja e NVM-ve, etj, kërkojnë shuma të konsiderueshme të resurseve financiare. Ndikimi i ndryshimeve të politikës tregtare në anën e shpenzimeve të buxhetit qeveritar, dhe kështu fleksibiliteti aktual i politikës bërjes fiskale për qëllime zhvillimore, është më i tërthortë, por megjithatë ekziston. Efekti pozitiv apo negativ i të hyrave në anën e të hyrave ka disa implikime të rëndësishme në shpenzimet e zhvillimit (ose të buxhetit të zhvillimit), dhe me të vërtetë ekziston korrelacion pozitiv midis të hyrave tatimore tregtare dhe disa shpenzimeve kyçe të lidhura me zhvillimin, të tilla si arsimi dhe shëndetësia, si dhe shpenzimet për investime publike, etj. Sikurse që zvogëlohen të hyrat ashtu zvogëlohen edhe kapacitetet qeveritare për krijimin e politikave dhe aftësia e saj manovruese. Kjo reflektohet më së shumti në shpenzimet sociale dhe buxhetin*

---

9 Finger, M. J. dhe Schuler, P. (1999), Implementation of Uruguay Round Commitments: the Development Challenge, World Bank policy research working paper no. 2215, September 1999.

10 Rodrik, D. (2001), The Global Governance of Trade As If Development Really Mattered, Background Paper, New York: UNDP

*për zhvillim, pasi që për shumë arsye qeveritë janë të obliguara të mbajnë disa shpenzime themelore, siq janë ato të lidhura me sigurinë e tyre kombëtare.*

*Për shembull, qeveria e Nepalit aktualisht është duke nxjerr rreth 27% të të hyrave totale nga tatimet e importit. Totali i tatimit të mallërave i bazuar në tregtinë e jashtme është më shumë se 32% të totalit të buxhetit të rregullt. Shpenzimet e tilla si ushtarake, policore dhe të servisimit të borxhit përbëjnë më shumë se 40% (në buxhetin e vitit 2003 ishte 50%) të buxhetit qeveritar. Duke pasur parasysh situatën konfliktuoze politike do të jetë shumë e vështirë për të zvogëluar shpenzimet që lidhen me sigurinë në ballafaqim me një rënie aktuale të të hyrave totale për shkak të tarifave më të ulëta.*

*Ekzistojnë rrugë për mbulimin e të hyrave të humbura, nëpërmjet mënyrave të ndryshme "të lejuara" të rritjes së tatimeve të lidhura me tregtinë siq është TVSH-ja. Megjithatë, efektiviteti i tyre përballë tatimeve më drejtpërdrejtë të lidhura me tregtinë është i dyshimtë.*

## **2. Politikat Makroekonomike dhe Zgjerimi i Tregtisë**

*Pra, rezultati përfundimtar është se përmbajtja zhvillimore e politikave makroekonomike, në këtë rast të veçantë politika fiskale, ndryshon. Në kontekstin e liberalizimit rapid të tregtisë, kjo është mjaft ironike, sepse kërkimet e kohëve të fundit gjithashtu tregojnë se politika ekspanzive makroekonomike, e cila kërkon më shumë burime fiskale dhe alokime më të mira buxhetore për qëllime të zhvillimit (social dhe industrial), dëshmon se është më e dobishme për të zgjeruar kapacitetin tregtar të vendit. Liberalizimi*

*rapid dhe i parregullt tregtar prandaj i shërben qëllimit të kundërt, përderisa pretendon të zgjerojë tregtinë, në fakt e kufizon atë.*

*Hulumtimet e fundit empirike demostrojnë se politika makroekonomike ekspansioniste aktualisht rezulton në rezultate më të mira tregtare. Duke shiqur në politikat tregtare dhe të investimeve (IHD) të një grupi të vendeve të Amerikës Latine në lidhje me performancën e tyre të rritjes gjatë tri dekadave të fundit, John Weeks, për shembull, argumenton se raporti në mes të tregtisë dhe rritjes së BPV-së varet nga dinamika e mekanizmit transmetues dhe komplementaritetit (ose mungesës së tij) midis sektorit të eksportit dhe jo-eksportit në ekonominë vendore. Rritja e BPV-së mund të shtohet vetëm nëse sektori i eksportit mund të gjenerojë dinamizëm pozitiv të rritjes në sektorin jo-eksportues (Weeks, 2003).<sup>11</sup> Ky komplementaritet ka qenë më i madh në vendet ku mekanizmi i transmetimit ishte lehtësuar nga politikat ekspansioniste makroekonomike (politikat monetare dhe fiskale si dhe regjimi i kursit devizor) dhe ku zbatohen masa të forta të politikës industriale. Korniza politike kontraktive makroekonomike - për shembull duke përdorur politikat restriktive monetare dhe fiskale – me siguri do të ndikojë negativisht "dinamizmin e eksportit", të matur me elasticitetin e eksportit real dhe BPV-së së jo-eksportit, duke shtypur kërkesën (sidomos vendore). Kjo redukton efektin stimulues të eksportit në prodhimtarinë jo-eksportuese dhe kështu në rritjen e BPV-se (Weeks 2003). Lidhja operon nëpërmjet efektit të shtrydhjes dhe efektit të të ardhurave të shpenzimeve qeveritare. Ajo gjithashtu*

---

11 Weeks, J. (2003), Exports, Foreign Investments and Growth in Latin America: Scepticism by way of simulation, Working Paper Series No. 117, School of Oriental and African Studies, Department of Economics: London

*mund të jetë e favorshme për tërheqjen e IHD-ve. Për sa kohë që nuk ka presione të larta inflacioniste, një rritje e shpenzimeve qeveritare për të zgjeruar tregun vendor shërben për të tërhequr IHD. Lëvizja e Kinës për zhvillimin e provincave perëndimore, për shembull, nuk shkoi pa u vërejtur nga investitorët e huaj.*

*Politika efektive sociale dhe struktura e drejtë dhe e barabartë qeverisëse, duke dhënë prioritet shpenzimeve në edukim dhe shëndetësi si dhe investimeve në infrastrukturën bazike, e cila në masë të madhe varet nga politika ekspansioniste makroekonomike, janë gjithashtu të rëndësishme për rezultate zhvillimore pozitive dhe të qëndrueshme njerëzore si dhe performancë të rritur tregtare.*

*Burimi: Keklik, M. and Memis, E. (2005), Human Development Impact Assessment of Trade Policies, Policy Papers, UNDP Regional Centre in Colombo, Sri Lanka.*

## **2.1 Politika tatimore në kontekstin e politikës tregtare**

Kohën e fundit, Qeveria e Kosovës ndërmori hapa të mëdhenj në bërjen e politikës tatimore më të favorshme për biznesin dhe investimet (skema e re e tatimeve ka hyrë në fuqi më 1 janar 2009). Kosova tani është duke aplikuar shkallë tatimore shumë konkurruese krahasuar me rajonin e Evropës Juglindore (EJL). Përveç kësaj, sistemi tatimor është i favorshëm për aktivitetet e eksportit. Eksportet nuk ngarkohen me TVSH apo tarifa doganore. Në rastin e TVSH-së, duhet të sqarohet se nuk ngarkohen me TVSH lëndët e para të importuara (aplikohet zbritja e TVSH-së), lëndët tjera të para për prodhim, si dhe

produktet përfundimtare të eksportuara. Në raste të tjera, TVSH-ja është uniforme dhe si e tillë mbledhet për të gjitha të mirat, përveç disa rasteve të veçanta (shih më poshtë).

Siç u cek më sipër, të mirat që destinohen për tregjet e huaja nuk ngarkohen me taksa doganore. Në anën tjetër, importet, me disa përjashtime, ngarkohen me tarifë doganore prej 10%. Së pari, prodhimet nga Serbia dhe Mali i Zi nuk ngarkohen me tarifa doganore, dhe vendet me të cilat Kosova ka nënshkruar MTL ngarkohen me vetëm 1% tarifë. Gjithashtu, disa kategori të prodhimeve janë të lira nga doganat; për shembull, plehurat artificiale, pajisjet mjekësore, dhe së fundi të mirat për qëllime humanitare. Në vitin 2004 disa prodhime dhe makineri bujqësore ishin liruar pjesërisht nga tarifatat doganore dhe TVSH-ja.<sup>12</sup> Gjatë vitit 2007, një numër i Rregulloreve kanë hyrë në fuqi që të reduktojnë edhe më tej tarifatat doganore për një numër të mallrave.<sup>13</sup>

Në Kosovë, mallrat e tilla si duhani, kafeja, pijet alkoolike dhe jo-alkoolike, vera, birra, karburantet dhe produktet e ngjashme, automjetet, etj. ngarkohen me akcizë. Akciza zbatohet gjithashtu për të njëjtat kategori të mallrave që prodhohen brenda Kosovës. Shkalla është përcaktuar si tarifë specifike. Me qëllim të stimulimit të prodhimit vendor akciza nuk paguhet për mazut në rastet kur shfrytëzohet si lëndë e

---

12 Rregullorja e UNMIK-ut 2004/13 përcakton (a) redukimin e tarifave doganore për të mirat kapitale nga 10% në 0%; (b) redukimin e tarifave doganore për lëndën e parë për agro-biznes dhe disa sektorëve të tjera prodhues nga 10% në 0%; dhe (c) redukimin e tarifave doganore të substancave të ndërmjeme për përpunimin e mëtejshëm nga 10% në 0%.

13 Rregullorja e UNMIK-ut 2007/12 përcakton përjashtime nga tagrat doganore të disa lëndëve të para, të domosdoshme për procesin e prodhimit; sipas Rregullores 2007/1 asnjë tagër doganore nuk kërkohet për lëndë djegëse dhe produktet e lëndëve djegëse të destinuar për aktivitete të prodhimit; dhe sipas Rregullorja e UNMIK-ut 2007/31 nuk kërkohen tagra doganore për importin e grurit dhe misrit.

parë.

## 2.2 Liberalizimi i Tregtisë

Siç u cek më herët, Kosova është e përkushtuar për liberalizimin e tregtisë. Institucionet e Kosovës kanë qenë pjesë e proceseve dhe ndërmarrjeve për liberalizimin e tregtisë në rajon, veçanërisht për ato të inicuar nga Pakti i Stabilitetit. Edhe pse, jo pjesë e barabartë në këtë mekanizëm, Kosova e bëri të qartë përkushtimin e saj për të respektuar obligimet e Memorandumit të Mirëkuptimit për Lehtësimin dhe Liberalizimin e Tregtisë (në vijim MM), të nënshkruar nga vendet e Evropës Juglindore në vitin 2001 nën përkujdesjen e Paktit të Stabilitetit.<sup>14</sup> Objektivi përfundimtar i këtij aktiviteti ishte zbatimi i MTL-ve dypalëshe midis vendeve të rajonit. Sipas MM-së, MTL-të ishin të detyrueshme për vendet nënshkruese, përveç Kosovës në të cilin rast vendet vetëm u këshilluan që të nënshkruajnë MTL nëse ata e konsiderojnë këtë hap si të dobishëm. Sidoqoftë, Kosova ishte aktive në këtë proces, duke e nënshkruar MTL-në e parë me Shqipërinë, dhe më vonë me Maqedoninë, Bosnje e Hercegovinën dhe Kroacinë. I tërë procesi i negociatave përfundoi me zgjerimin e marrëveshjes së CEFTA-s me vendet e Evropës Juglindore në vitin 2006, kështu, duke konvertuar marrëveshjet dypalëshe në një MTL të vetme (shih më shumë për CEFTA në Kutinë 2). Kosova u bë anëtare e barabartë me të drejta të plota. Megjithatë Kosova si pjesë e marrëveshjes së CEFTA-s ka përgjegjësi të caktuara, ekzistojnë shumë aspekte pozitive të

---

<sup>14</sup> Duhet të theksohet se ky Memorandum Mirëkuptimi nuk obligon vendet nënshkruese të marrëveshjes për tregti të lirë me Kosovën, përkundër faktit se i njëjti dokument obligon vendet e tjera të nënshkruajnë marrëveshjen mes njëri-tjetrit.

këtij procesi. Një nga këto përfitime, së pari, do të jetë rrjedhja e lirë e mallrave dhe shërbimeve. Qëllimi i CEFTA-s është krijimi i rregullave dhe mekanizmave me anë të të cilave qeveriset tregtia e jashtme në rajon. Këto rregulla kanë qenë të harmonizuara me principet e BE-së dhe OBT-së. Përvoja e fituar në tregtinë me rajonin do të bëjë produktet e Kosovës konkurruese për tregun e BE-së dhe më gjerë. Gjithashtu, Kosova në këtë proces do të formësojë institucionet dhe politikat që janë në përputhje me kërkesat e OBT-së (shih diskutimin më pas). Një tjetër qëllim i CEFTA-s është krijimi i një tregu tërheqës rajonal i cili do të krijojë mundësi të reja për bizneset vendore apo investitorët e huaj. Ky dimension është veçanërisht i rëndësishëm për Kosovën, pasi IHD-të janë të një rëndësie kapitale për përmirësimin e pozitës konkurruese të industrive Kosovare në tregjet e huaja.

**Kutia 2: Marrëveshja e Evropës Qëndrore për Tregti të Lirë (CEFTA)**

*Marrëveshja origjinale CEFTA u nënshkrua nga vendet e Grupit të Vishegrad-it (që dmth. Polonia, Hungaria dhe Republikat Çeke dhe Sllovake) në dhjetor 1992 në Poloni dhe hyri në fuqi në korrik 1994. Përmes CEFTA-s, vendet pjesëmarrëse shpresuan të mobilizojnë përpjekjet për t'u integruar në BE-së dhe institucionet tjera ndërkombëtare. Më pas, nën përkujdesin e Paktit të Stabilitetit për EJT, Marrëveshja mbi Amendimin dhe zgjerimin të CEFTA-s u nënshkrua në Bukuresht më 19 dhjetor 2006. Kjo Marrëveshje zëvendësoi të gjitha marrëveshjet dypalëshe të aplikuara më parë në rajonin e EJT-së. Implementimi i plotë i CEFTA-s filloi në fund të vitit 2007.*

*CEFTA përcakton një mekanizëm të përmirësuar për zgjidhjen e*

*mosmarrëveshjeve që mund të ndodhin gjatë implementimit të Marrëveshjes, e cila paraqet një cilësi të re dhe një faktor të sigurisë më të lartë të liberalizimit në rajon. Përveç asaj që u cek me sipër, janë hapur fusha të reja për zhvillimin e marrëdhënieve reciproke në lidhje me liberalizimin e shërbimeve, çështjeve të investimeve, prokurimeve publike, pronësisë intelektuale, dhe mundësinë e CEFTA kumulimit të origjinës midis Palëve.*

*CEFTA gjithashtu përcakton që marrëdhëniet reciproke tregtare midis palëve të CEFTA duhet të zhvillohen në përputhje me rregullat e OBT-së. Kjo praktikisht nënkupton se edhe para anëtarësimit në OBT, karakteristikat sistematike të ekonomisë duhet të iu përshtaten rregullave të OBT-së, që paraqet faktor të fortë të parashikueshmërisë dhe transparencës për partnerët e jashtëm, investitorët e huaj dhe për vetë ndërmarrësit.*

*Burimi: <http://www.cefta2006.com> (qasur më: 25 maj 2009)*

Megjithatë, përvoja e Kosovës me CEFTA-n deri tani nuk ka qenë shumë pozitive për shkak të fërkimeve politike të vazhdueshme në rajon. Pasiqë UNMIK-u ishte nënshkruar në emër të Kosovës (përfaqësimi ndërkombëtar i Kosovës ishte e drejtë e rezervuar e UNMIK-ut deri në shpalljen e pavarësisë, dhe procesi negociator për MTL-të dypalëshe dhe CEFTA-s ishin udhëhequr nga përfaqësues të UNMIK-ut), Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina nuk i njohin institucionet e Republikës së Kosovës dhe dokumentacionin e lëshuar nga ato. Kështu, eksporti i Kosovës në këto vende që disa muaj po vazhdon të jetë i bllokuar, edhe pse ka përpjekje të vazhdueshme për zgjidhjen e situatës. Përveç kësaj çështjeje, është një ndjenjë e përgjithshme në disa institucione Kosovare dhe komunitetin e biznesit që CEFTA nuk do të prodhojë

përfitimet e pritura për Kosovën. Ka indikacione se procesi i hyrjes në CEFTA nuk ishte i menduar mirë, dhe se vendimet janë marrë pa ndonjë analizë apo vlerësim të efekteve reale të cilat do të rezultonin nga ky proces.<sup>15</sup>

Sa i përket tregut të BE-së, marrëdhëniet tregtare të Kosovës me BE-ne janë specifikuar me Rregulloren e Këshillit 2007/2000 të Shtatorit të vitit 2000. Kjo Rregullore e njeh Kosovën si një njësi autonome doganore, ku 95% të prodhimeve të Kosovës janë përjashtuara nga tarifatat doganore. Doganat dhe kufizimet sasiore mbeten në fuqi vetëm për një numër të kufizuar të produkteve (mish viçi, sardele, verë dhe disa produkte të tekstilit). Gjithashtu, Kosova është pjesë e Procesit të Stabilizim Asociimit (PSA) edhe pse në një formë më ndryshe krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Pasiqë një numër i vogël i vendeve të BE-së nuk e kanë njohur Kosovën e pavarur, Mekanizmi Përcjellës i Kosovës (MPK) mbetet në fuqi i dizajnuar për të udhëhequr Kosovën drejt reformave të nevojshme për anëtarësim në BE. Ky mekanizëm duhet të përdoret për një qasje më të lehtë në tregun rajonal dhe të BE-së, pasi që BE nëpërmjet PSA (MPK në rastin e Kosovës) është e përkushtuar për liberalizimin e mëtejshëm me vendet e rajonit dhe në mes të vendeve të rajonit. Marrëdhëniet me BE janë thelbësore për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës duke e pasur parasysh faktin se BE është tregu me potencialin më të madh, jo vetëm për Kosovën por për të gjithë rajonin, dhe burimi kryesor i

---

<sup>15</sup> Ky përfundim është nxjerrë në bazë të rezultateve të raportit të përpiluar nga Keklik dhe Gashi (2009), i cili planifikon asetet e kapaciteteve dhe nevojat e institucioneve të Kosovës në lidhje me analizimin dhe formulimin e politikave tregtare. Ky raport është porositur nga UNDP-ja. (Shih diskutimin më pas).

investimeve.

Zhvillim i kohës së fundit në kontekstin e liberalizimit është përfshirja e Kosovës në Sistemin e Përgjithësuar të Preferencave (GSP) nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (shih më shumë në Kutinë në vazhdim). Ky program është dizajnuar për të nxitur rritjen ekonomike në vendet në zhvillim duke ju ofruar trajtim preferencial për numër të konsiderueshëm të mallrave. Deri më tani, tregu i SHBA-ve nuk ka pasur pjesëmarrje sinjifikante në eksportet totale të Kosovës, megjithatë ky zhvillim mund të ndryshojë situatën. GSP potencialisht krijon mundësi të reja për eksportuesit Kosovar, edhe pse efektet reale mund të marrin kohë më të gjatë.

### Kutia 3: Sistemi i Përgjithësuar i Preferencave (GSP)

*Programi GSP është krijuar në 1 janar 1976 me synimin për të zgjeruar zgjedhjet e industrisë amerikane dhe konsumatorëve në krijimin e mundësive ekonomike përmes rritjes së eksporteve nga vendet në zhvillim. Programi GSP ofron hyrje pa doganë në tregun e SHBA për më shumë se 3,400 eksporte nga vendet në zhvillim të caktuara si përfituese dhe rreth 1,500 eksporteve shtesë nga vendet më së paku të zhvilluara përfituese. Programi GSP e zgjeron këtë mundësi për qasje të shtuar në tregun e SHBA për 131 vende dhe territore (përfshirë 44 vende më së paku të zhvilluara).*

*Burimi:* [http://www.ustr.gov/Trade\\_Development/Preference\\_Programs/GSP/Section\\_Index.html](http://www.ustr.gov/Trade_Development/Preference_Programs/GSP/Section_Index.html) (qasur më: 25 maj 2009)

## 2.3 Anëtarësimi në OBT

Megjithëse, shumë të vetëdijshëm se anëtarësimi në OBT është një proces shumë kompleks, institucionet Kosovare janë duke e konsideruar pranimin në OBT si një hap të rëndësishëm drejt integritit të plotë në sistemin botëror tregtar. Para së gjithash, duhet të kuptohet se MTL-të ose marrëveshjet rajonale në lidhje me liberalizimin e tregtisë (të tilla si CEFTA), janë gjithmonë zgjidhja e dytë më e mirë në krahasim me liberalizimin multilateral, diçka që do të siguronte anëtarësimi në OBT. Anëtarësimi në OBT është një proces kompleks për dy arsye: së pari, ky proces kërkon përkushtim të vendit aplikues për zbatimin e politikave që janë të lidhura me procesin e anëtarësimit në OBT; dhe, së dyti, është kompleksiteti i çështjeve që mund të ngritën nga anëtarët e OBT-së gjatë procesit të negociatave dhe që e komplikon tërë procesin. Negociatat përfshijnë shumë çështje dhe disa mjaft komplekse, të tilla si: bujqësinë, industrinë e tekstilit dhe të veshjes, sistemin bankar, telekomunikacionin, standardet industriale dhe të prodhimit, pronësinë intelektuale, etj.

Megjithatë, përfitimet nga anëtarësimi janë të mëdha, veçanërisht për vendet e vogla siç është Kosova, të cilat varen shumë nga tregtia e jashtme. Përfitimet janë si vijon:

- Kërkesat për anëtarësim në OBT rezultojnë në fuqizimin gjithëpërfshirës të politikave dhe institucioneve të vendit;
- Anëtarësimi në OBT siguron qasje në tregjet kryesore botërore. Kosova si vend në tranzicion do të përfitonte nga klauzola e Kombit Më Të Favorizuar. Ky status do të thotë

trajtim të barabarte ose jo-diskriminues nga vendet anëtare të OBT-së. Çka do të thotë kjo? Nëse një vend anëtar i ofron preferenca një vendi tjetër anëtar atëherë këto preferenca do të aplikohen edhe për pjesën tjetër të vendeve anëtare (në këtë rast edhe për Kosovën). Ky trajtim ka shumë implikime për marrëdhëniet brenda ekonomisë nacionale të vendit anëtar dhe pozitën e tij në tregun e huaj. Ky koncept është gurthemel i politikave të OBT-së; dhe

- Anëtarësimi mundëson qasje në mekanizmin për zgjidhjen e kontesteve. Për Kosovën si vend i vogël ky mekanizëm është me rëndësi të veçantë.

OBT ka luajtur një rol të rëndësishëm në liberalizimin e tregtisë botërore. Megjithatë, heqja e barrierave tarifore si rezultat i negociatave brenda OBT-së ka shkaktuar shfaqjen e një kategorie të re të pengesave, që janë, barrierat jo-tarifore. Këto barriera në të shumtën e rasteve e pengojnë tregtinë ndërkombëtare më tepër se barrierat tarifore. Kjo ndodh për shkak se rregullat e OBT-së nuk janë saktësisht specifike në këtë kontekst, duke lejuar vendet që t'i aplikojnë ato. Prandaj, Kosova do ta shikojë liberalizimin e mëtejshëm (përfshirë anëtarësimin në OBT) në kontekst të shumë faktorëve të tjerë ashtu që të përfitojë më së shumti nga procesi.

## **2.4 Aspektet institucionale dhe regjimi tregtar i Kosovës**

Cilësia e institucioneve është faktor shumë i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe po ashtu në ndërmarrjen e aktiviteteve biznesore jashtë vendit. Aktualisht, së bashku me faktorët klasikë të njohur – kapitali fizik dhe njerëzor - cilësia e institucioneve është konsideruar si përparësi krahasuese e një

vendi së bashku me diturinë, sistemin financiar, si dhe faktorët tjerë relevant. Performanca e institucioneve kryesisht është përgjegjëse për krijimin e klimës së favorshme për biznes. Megjithëse, efektet e cilësisë institucionale mund të duken të lidhura në mënyrë indirekte me zhvillimin e sektorit të eksportit, ekzistojnë disa mekanizma institucionalë që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me zhvillimin dhe avancimin e sektorit të eksportit. Në Kosovë, roli kryesor institucional është në MTI e cila propozon politikat dhe dizajnon mekanizmat për implementimin e këtyre politikave. Një zhvillim i rëndësishëm brenda avancimit institucional është Ligji mbi Aktivitetet e Tregtisë së Jashtme i miratuar në vitin 2003, kurse një tjetër ligj me rëndësi të veçantë është Ligji Anti-dumping, i cili është hartuar dhe pritet së shpejti të miratohet nga Kuvendi. Këto ligje rregullojnë marrëdhëniet tregtare dhe përcaktojnë mekanizmin për realizimin e tregtisë së jashtme.

Në kontekstin e legjislacionit, duhet përmendur Kodi Doganor i cili ishte aprovuar në bazë të Rregullores 2004/1. Kodi vendosi mekanizma të ri për të lehtësuar tregtinë. Elementet favorizuese të Kodit për realizimin e aktiviteteve të biznesit përfshijnë dispozita për:

- Deponimi doganor i cili mundëson deponimin e mallrave nën mbikëqyrjen e Doganave. Përfitimet nga një sistem i tillë janë gjithëpërfshirëse; përparësia kryesore e depove doganore është se ato eliminojnë ekspozimin e eksportuesve ndaj shpenzimeve të doganave dhe tatimeve për mallrat e pa shitura. Kjo do të thotë, që për produktet e deponuara në depot doganore pagesa e detyrimeve është shtyrë deri në shitjen e mallrave. Përfitimet tjera të kësaj strukture shtrihen në mbrojtjen e bizneseve nga rreziqet inflacioniste, duke ju ofruar bizneseve mënyrë më të

volitshme për të testuar tregun dhe harmonizuar strategjitë e tyre të eksportit, madje duke iu ofruar edhe siguri fizike për produktet e kompanive.

- Lirim i rregulluar dhe i monitoruar i përpunimit të brendshëm dhe të jashtëm; me fjalë të tjera, duke bërë të mundur që kompanitë individuale të sjellin në Kosovë, pa paguar tatime apo ngarkesa tjera fiskale, komponentët për prodhimin e mallrave të destinuar për eksport;
- Transiti i mallrave nën garancion bankar dhe forma të tjera. Kjo procedurë lejon lëvizjen nga një pikë në tjetrën brenda Kosovës të mallrave të vendeve të tjera në transit nëpër Kosovë, dhe mallrave që prodhohen në Kosovë por të destinuar për eksport.
- Themelimi i zonave të lira ekonomike për përpunim dhe eksport nëse këto instrumente konsiderohen të nevojshme nga politikëbërësit. Në këto zona kompanitë do të tatimoheshin shumë pak ose aspak për të inkurajuar zhvillimin e tyre.

Në mënyrë që të realizohen instrumentet e përcaktuara sipas Kodit Doganor, është e nevojshme rritje e mëtejshme e efektivitetit të administratës doganore. Ky shërbim ka qenë përgjegjës për pjesën më të madhe të të hyrave të mbledhura për buxhetin e vendit. Megjithatë, përkundër këtyre arritjeve, mundësia e kontrabandimit është çështje brengosëse.

Administrata tatimore gjithashtu luan një rol të rëndësishëm veçanërisht në rimbursimin e TVSH-së për mallrat e destinuar për eksport.

Një dimension institucional shumë i rëndësishëm në kuadër të politikës tregtare është prezenca e mekanizmave institucional për financim dhe sigurim të eksportit. Në Kosovë këto

mekanizma nuk ekzistojnë, duke i shtyer transaksionet të realizohen në para të gatshme. Këto mekanizma do të ofronin ndihmë kompanive eksportuese në rastet kur rreziku financiar i një vendi apo një industrie specifike është më i lartë se potenciali i sektorit bankar për të mbuluar këtë rrezik. Këto mekanizma nuk do t'u bëheshin konkurrencë institucioneve financiare (cilat në Kosovë ofrojnë garanci të eksportit) por do të bashkëvepronin për forcimin e sektorit të eksportit në Kosovë (instrumente të tilla mund të jenë letra kreditore, garancione që mbulojnë rrezikun e pagesës, garancionet e pagesës avans, çeqet devizore, etj.) Në rastin e Kosovës këto instrumente bëhen edhe më të rëndësishme duke pasur parasysh faktin se pjesa më e madhe e sektorit të ndërmarrjeve janë NVM të cilat janë shumë të ndjeshme kur përballen me një nivel të caktuar të rrezikut dhe të konkurrencës së jashtme.

Infrastruktura rrugore është një tjetër dimension problematik. Kosova është vend i mbyllur dhe me lidhje relativisht të kufizuara me rajonin dhe më gjerë. Autostrada e cila lidhë Kosovën me portin e Durrësit në Shqipëri i krijon dalje në det Kosovës. Kjo do t'i mundësoj ekonomisë Kosovare përfitime në kuptim të uljes së shpenzimeve të transportit pasi që transporti detar është jashtëzakonisht më i lirë dhe me më pak "komplikime" se ai rrugor.<sup>16</sup> Në kontekst të transportit duhet përmendur edhe mungesën e Kosovës në Transports Internationaux Routiers (TIR), sistem ndërkombëtar tranziti. Ky sistem e bën të mundur transportimin e produkteve prej vendit të origjinës deri në vendin e destinacionit pa kontroll

---

16 Sipas Hausman (2001) shpenzimet e transportit rrugor janë shtatë here më të larta se shpenzimet e transportit detar. Shih Hausmann, R. (2001), *Prisoners of Geography, Foreign Policy*, Janar-Shkurt, f. 45-53

doganor në vendet e tranzitit. Ky instrument minimizon ngarkesat financiare dhe administrative, prandaj, Kosova duhet të aspirojë për anëtarësim në këtë institucion.

Në kuadër të institucioneve duhet cekur edhe organizmat të cilët kujdesen për standardin dhe kualitetin e produkteve, të njohura si Standardet Sanitare dhe Fitosanitare. Në Kosovë, në këtë drejtim janë të angazhuara ministri dhe agjensione, si Agjencioni i Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës (AVUK) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Agjencioni për Standardizim dhe Akreditim në kuadër të MTI-së dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Një ndër faktorët e rëndësishëm për nivelin e ultë të eksportit në tregjet perëndimore janë standardet shëndetësore dhe të sigurisë të kërkuara nga partnerët e jashtëm. Ky dimension i reformës institucionale është në veçanti i rëndësishëm në lidhje me anëtarësim e plotë të Kosovës në OBT. Përveç fuqizimit të institucioneve për implementimin e standardeve sanitare dhe fitosanitare, si anëtar i OBT-së, Kosova do të jetë e obliguar që të zhvillojë institucionet mbi trajtimin e Barrierave Teknike në Tregti (TBT), dhe ato mbi të Drejtat e Pronës Intelektuale në kuadër të Tregtisë (TRIPS). Këto instrumente janë të rëndësishme gjithashtu edhe për të monitoruar aktivitetet e vendeve tjera të cilat eksportojnë në vend në kuptim të nivelit të plotësimit të standardeve të importeve.

Një komponentë tjetër institucionale janë edhe organizatat ndërkombëtare të cilat operojnë në Kosovë, një numër i të cilave ka mbështetur avancimin e sektorit eksportues në Kosovë. Këta organizma kryesisht kanë qenë të koncentruar në krijimin e kapaciteteve institucionale apo zhvillimin e

bizneseve në mënyrë që të ngrisin konkurrueshmërinë e industrive vendore. UNDP, misioni i BE-së, dhe Banka Botërore kanë qenë të përfshira në mbështetjen e institucioneve të lidhura me tregtinë, në veçanti brenda MTI-së. Në anën tjetër, USAID-i nëpërmjet programeve të ndryshme ka mbështetur bizneset në gjithë Kosovën në proceset e ndryshme të biznesit, dhe në një masë në aktivitetet e eksportit.

Në fund, asociacionet e biznesit janë faktorë të rëndësishëm në promovimin e eksportit. Detyra e tyre në kontekst të promovimit të eksporteve ka qenë kryesisht në ofrimin e informatave për tregjet e jashtme.



### **3. DREJTIMET E POLITIKËS TREGTARE TË KOSOVËS**

Kosova është plotësisht e përkushtuar për liberalizim të tregtisë. Zgjerimi i tregtisë në Kosovë përmes liberalizimit të tregtisë kërkon lëvizje në tri drejtime. Këto janë racionalizimi dhe zëvendësimi i importit, lehtësimet në tregti, dhe promovimi i eksportit. Kjo është strategjia e integruar e eksportit e UNCTAD-it (Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Tregti) e cila i jep rëndësi të barabartë konkurrencës në tregun vendor dhe konkurrencës në tregun e jashtëm. Kategoria e parë merret me politikat që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve konkurruese në tregun e brendshëm. Grupi i dytë i politikave konsiston në masat për lehtësimin e tregtisë së jashtme. Instrumentet e grupit të dytë synojnë përmirësimin e burokracisë në kufi dhe zvogëlimin e kostove të transaksioneve të cilat shfaqen në momentin e kalimit të kufirit. Dhe në fund, grupi i tretë ka të bëjë me masat të cilat kanë për qëllim promovimin e eksportit. Këto instrumente fokusohen në përmirësimin e performansës së kompanive vendore në tregjet e jashtme

Megjithatë, MTI dhe Qeveria e Kosovës, për këtë çështje janë plotësisht të vetëdijshme se liberalizimi i tregtisë, vetëm si i tillë, nuk është i mjaftueshëm për të përmirësuar zhvillimin. Së pari, politikat tregtare duhet të formulohen, zbatohen dhe vlerësohen në mënyrë të tillë, që i japin më tepër përparësi zhvillimit se sa vet rezultateve të tregtisë ndërkombëtare. Kjo do të thotë që reduktimet tarifore dhe jo-tarifore duhet të

menaxhohen përmes selektimit sektorial (i kufizuar në kohë), të radhitura dhe në faza.

Së dyti, në mënyrë që përfitimet nga liberalizimi i tregtisë të jenë më të lartat dhe më të qëndrueshmet, jo vetëm politikat tregtare, por edhe “politikat zhvillimore që kanë të bëjnë me tregtinë” duhet të kuptohen dhe të menaxhohen mirë. Siç kemi theksuar, zgjerimi i konkurrencës, për shembull, është i një rëndësie të madhe për promovim të eksportit. Por politikat që përmirësojnë konkurrueshmërinë nuk janë politikat tregtare të drejtpërdrejta, por politika të lidhura me tregtinë (p.sh. politikat që kanë implikime shumë të rëndësishme sa i përket tregtisë).

Së fundi, tregtia është një koncept i ndërlidhur që ndikon pothuajse në të gjitha fushat e jetës ekonomike dhe sociale. Prandaj, ekziston një nevojë urgjente institucionale për sforcimin e bashkëpunimit dhe koherencës midis të gjithë aktorëve relevant që formojnë sistemin e tregtisë në Kosovë. MTI është e përkushtuar për përforcimin e marrëdhënieve me sektorin privat, shoqatat tregtare, sindikatat e punëtorëve dhe institucionet ndërkombëtare si dhe përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes.

Prandaj, MTI konsideron se politika tregtare në Kosovë duhet të fokusohet në politikat tregtare në njërën anë dhe politikat zhvillimore që kanë të bëjnë me tregtinë në anën tjetër, në mënyrë që të jetë e suksesshme në kontribuiimin për procesin zhvillimor. Për deri sa veprohet kështu, aspektet hapsinore dhe të përkohshme të tregtisë dhe politikave të ndërlidhura duhet të konsiderohen me shumë kujdes. Në mënyrë që të arrihet trend i mirë i politikës tregtare, dosido, duhet të përmbushen

nevojat institucionale për tregti dhe të formulohet politika zhvillimore që ka të bëjë me tregtinë. Prandaj në nënseksionin e fundit të këtij seksioni ne do të diskutojmë disa nevoja institucionale të cilat Kosova duhet t'i adresojë në afat të shkurtë.

Nën-seksionet diskutojnë politikat tregtare së pari në kontekst të marrëveshjeve tregtare dhe, së dyti politikave zhvillimore që kanë të bëjnë me tregtinë. Këto dyja janë njësoj të rëndësishme. Më tutje, diskutimin do ta bartim në nevojën për kohezion të fuqishëm institucional, në mënyrë që tregtia dhe politikat e lidhura me tregtinë të funksionojnë më mirë.

Siç është parë në diskutimin e mësipërm, një numër i aspekteve të trajtuara këtu janë çështje të ndërvarura. Andaj, në këtë rast nuk kërkohen vetëm përpjekjet e MTI-së por edhe përpjekjet e një numri të aktorëve të tjerë të përfshirë në procesin e politikave tregtare (institucionet qeveritare dhe organizatave tjera jashtë qeverisë). Kjo situatë është tipike për shumicën e dimensioneve të cilat diskutohen këtu. Në raste të tilla ky dokument propozon masa për t'i adresuar çështjet së bashku, ndërsa në rastet kur përgjegjësia bie vetëm me MTI, kjo e fundit përkushtohet për aplikimin e masave specifike. Duhet të bëhet e qartë se rolin kryesor në procesin e bërjes së politikave tregtare e ka MTI, megjithëse ekziston një numër aktorësh tjerë qeveritar dhe të tjerë relevant të përfshirë në këtë proces për shkak të ndërvarshmërisë së madhe të politikës tregtare me funksionet e ndryshme ekonomike.<sup>17</sup>

---

<sup>17</sup> Më tepër mbi lidhjet institucionale në procesin e bërjes së politikës tregtare shihni planifikimin e aseteve të kapaciteteve dhe nevojat e institucioneve të Kosovës në lidhje me analizimin dhe formulimin e politikave tregtare. Ky raport është pregaditur për UNDP nga Keklik dhe Gashi (2009).

### **3.1 Marrëveshjet tregtare**

Janë tri aspekte të rëndësishme të çdo marrëveshjeje tregtare, të cilat nga ana e tyre përcaktojnë politikat tregtare në një vend. Këto janë qasja në treg, ku shumica e negociatave (për shembull në kuadër të OBT-së) zhvillohen në fushën e bujqësisë, qasja në tregun industrial, dhe shërbimet; ndryshimet ligjore, institucionale dhe rregullative; dhe horizonti i politikëbërjes.

#### **3.1.1. Qasja në treg**

Siç diskutuam më parë, marrëveshjet për liberalizimin e tregtisë, dhe veçanërisht anëtarësimi në OBT, kryesisht, i japin Kosovës mundësinë e qasjes në tregjet e vendeve tjera relativisht me lehtësi, me një kosto të redukuar të transaksioneve. Përveç kësaj, procesi nënkupton redukimin (ose dakordimin për të redukuar) e barrierave tarifore dhe jo-tarifore në disa fusha kyçe të importit. Të dy aspektet kanë disa implikime të rëndësishme në aspektin e rritjes ekonomike, punësimit, shpërndarjes dhe alokimit të të hyrave, asetëve dhe resurseve, dhe zhvillimit njerëzor në përgjithësi. Është më se e rëndësishme të krijohet një skemë që do t'i shërbente qëllimeve të përgjithshme zhvillimore të Kosovës.<sup>18</sup> Në këtë kontekst, pasi që këto çështje tejkalojnë përgjegjësitë e MTI-së, kjo e fundit konsideron se duhet të ndërmerren një numër hapash së bashku me aktorët tjerë relevant:

---

<sup>18</sup> Përcaktimi i duhur i shkallës së mbrojtjes efektive është aspekt kyq i negociatave për qasje në treg.

- Dimensioni i qasjes në treg duhet të shqyrtohet nga këndvështrimi i të qasurit në tregjet e vendeve tjera;
- Duhet të gjenerohet një skemë e barrierave tarifore dhe jo-tarifore për mallrat dhe shërbimet që do t'i jepnin Kosovës përfitimet më të mira nga perspektiva e zhvillimit human. Me rëndësi të njëjtë, megjithatë, kjo do të përfshinte çfarë mund të kërkojë Kosova nga vendet tjera dhe në cilat kategori të mallrave dhe shërbimeve.
- Ndikimi i redukimit të tarifave në fushat që janë të rëndësishme për diversifikimin industrial dhe bujqësor të Kosovës dhe realizimi i potencialit të saj konkurrues duhet të shqyrtohet shumë thellësisht.
- Ndikimi ndër-sektorial duhet të jetë gjithashtu pjesë e kësaj. Mundësitë për të shfrytëzuar produktet e Kosovës me përparësitë më të mëdha krahasuese, si mjet negociimi, po ashtu duhet të analizohet në mënyrë shumë rigoroze.
- Sistemet e tarifave preferenciale dhe dallimeve si dhe alternativat e një sistemi të thjeshtë të tarifave duhet gjithashtu të hulumtohen.

### **3.1.2. Korniza rregullative, ligjore dhe institucionale**

Kosova ka nevojë që të forcoj më tepër kornizën e saj rregullative, ligjore dhe institucionale, në mënyrë që të jetë në gjendje të integrohet në ekonominë globale nëpërmjet tregtisë dhe (kategorisë së caktuar) investimeve. Në këtë kontekst, MTI sugjeron një numër masash të cilat kërkojnë përpjekje të përbashkëta. E para, duhet të bëhet studimi i kornizës ekzistuese rregullative. E dyta, korniza e përgjithshme ekzistuese duhet të krahasohet me rregullat dhe rregulloret që kërkojnë marrëveshjet dypalëshe, rajonale dhe multilaterale

(OBT), dhe duhet të identifikohen zbrazëtitat. Hapi tjetër është të eksplorojnë fleksibilitetet brenda sistemit tregtar global i cili do të shërbejë më së miri për zbatimin efektiv të strategjisë zhvillimore të vendit, aktualisht të KASH-it, ndërsa të jetë në përputhje me rregullat shumëpalëshe dhe të tjera. Për shembull, një aspekt në këtë kategori mund të jetë: çfarë janë rregulloret ekzistuese të pronësisë intelektuale, dhe çfarë do të kërkojnë rregullat e OBT-së brenda marrëveshjes TRIPS. Pas këtij krahasimi, masat e politikës industriale që mund të jenë të kufizuara nga një ndryshim i tillë në sistemin e OBT-së duhet të ngriten dhe të rregullohen brenda parametrave të negociatave. Hapi i fundit do të ishte të gjenden fleksibilitetet dhe të mundohemi të justifikojmë përdorimin e tyre në skemat e mundshme të marrëveshjes tregtare. Kjo është një pjesë e hapësirës për politika, por duke shikuar çështjen më shumë nga perspektiva institucionale dhe rregullative.

### ***3.1.3. Horizonti i politikëbërjes***

Rregullat dhe rregulloret në OBT si dhe në MTL-të tjera si dhe përkushtimet në fushën e qasjes në treg mund të kufizojnë opcionet e politikave zhvillimore të një vendi anëtar. Por aty mund të ketë fleksibilitet të mjaftueshëm në sistem që i mundëson një vendi anëtar për të formuluar dhe implementuar strategjinë e tij unike zhvillimore. Ideja kryesore këtu është për të lidhur tregtinë e lirë dhe opcionet më të mira të politikave për Kosovën me fleksibilitet e saj për të formuluar dhe implementuar një strategji solide zhvillimore ndërsa participojmë në ekonominë globale. MTI konsideron se diskutimi mbi hapësirën për politika duhet të përqendrohet

kryesisht në ndikimin makroekonomik dhe sektorial të tregtisë së lirë dhe marrëveshjeve. Ndikimi duhet të vlerësohet dhe opcionet e nevojshme të politikave dhe modalitetet (siç janë radhitja dhe fazat) duhet të diskutohen. Një dimension i veçantë në këtë rast është ndikimi i redukimit të tarifave në të hyrat qeveritare dhe, në fund, aftësia e qeverisë për të mbajtur politikat zhvillimore, sociale dhe për çrrënjosjen e varfërisë. Madhësia e të hyrave tarifore në Kosovë është thelbësore në të hyrat e qeverisë. MEF (2009) raporton se rreth 85% e të hyrave të qeverisë janë të bazuara në tarifa. Pothuajse 65% janë të mbledhura në kufi, ndërsa rreth 20% janë të mbledhura brenda vendi.<sup>19</sup> Për më tepër, alternativat për të rigjenuar pjesën e humbur të të hyrave si rezultat i liberalizimit mund të kenë pasoja të rëndësishme për zhvillimin (dhe orientimin për barazi) e gjenerimit të të hyrave. Prandaj, duhet gjithashtu të hulumtohen alternativat e vlefshme nga perspektiva e zhvillimit human. Për shembull, bazuar në analizat e ndikimit fiskal, duhet të bëhen propozimet se si të kompenzohet rënja e mundshme e të hyrave. Aspektet strukturore të tatimit gjithashtu duhet të hulumtohen, në masën që ato kanë të bëjnë me çështjet e tregtisë dhe hyrjes në OBT. Ndikimi në rritjen e përgjithshme si dhe në investimet ndërkombëtare dhe vendore duhet gjithashtu të jenë një pjesë e rëndësishme e diskutimit, por me një qasje jogjyquese në lidhje me krijimin e mundësive të punësimit.

Nga çfarë është diskutuar në seksionin 3.1, rekomandimi

---

19 Ministria per Ekonomi dhe Financa (2009), *Buletini Gjysmëvjeter Makroekonomik*. [Online]. Gjetet në: [http://82.114.64.12/~mfe-ks/index.php?option=com\\_docman&Itemid=79](http://82.114.64.12/~mfe-ks/index.php?option=com_docman&Itemid=79) (Arrihet me : 08 June 2009).

kryesor për aktorët e përfshirë në dizajnimin e politikës tregtare është si më poshtë: Duhet të gjenerohet një skemë e marrëveshjeve së tregtisë së lirë (veçanërisht për OBT) që do të ofrojë përfitimet më të mëdha për zhvillim në Kosovë, duke përdorur tri fushat e mësipërme si pika fokale analitike. Kjo do të ofrojë argumente të forta për dialog si me partnerët vendor dhe ata negociues (ndërkombëtar). Kjo praktikë synon rritjen e mundësive si dhe reduktimin e rreziqeve të mundshme të hyrjes në OBT nga perspektiva zhvillimore. Rezultati përfundimtar i kësaj përpjekje do t'ju siguronte negociatorëve mjete të nevojshme zhvillimore dhe argumente kur ata të ulen rreth tavolinës negociuese gjatë procesit të anëtarësimit.

### **3.2 Politikat zhvillimore të lidhura me tregtinë**

Politikat zhvillimore të lidhura me tregtinë mund të klasifikohen si politika të nivelit makro ose mikro (ose mezo) politika të nivelit sektorial. Diskutimi i politikës makroekonomike të lidhur me tregtinë, tani për tani, është i kufizuar në ndikimin e liberalizimit të tregtisë në të hyrat e qeverisë dhe financimin e politikave sektoriale të lidhura me tregtinë.

Në pjesën në vazhdim dokumenti propozon disa masa të mundshme që mund të merren në nivelin sektorial. Diskutimi përqendrohet në dy sektorët prioritarë, këmbimet në sektorin e bujqësisë (ose në bujqësinë në përgjithësi) dhe këmbimet në sektorin industrial (ose në industrinë në përgjithësi). Përveç kësaj, ekzistojnë disa aspekte të ndërlidhura të cilat do t'i diskutojmë shkurtimisht në fund të seksionit. Në realitet, i gjithë diskutimi këtu shkon përtej mekanizmave dhe

funksioneve të MTI-së, duke u shtrirë në një numër të komponentëve të udhëheqjes në politikëbërjen e tregtisë ndërkombëtare.

Politikat sektoriale të lidhura me tregtinë kanë horizonte të ndryshme kohore në aspektin e ndikimit të tyre. Prandaj, menjëherë pas diskutimit sektorial ne diskutojmë opsionet e politikave në afat të shkurtë, të mesëm dhe të gjatë.

### **3.2.1 Diskutimet sektoriale<sup>20</sup>**

#### *3.2.1.1 Eksportet bujqësore*

Për të përmirësuar eksportet në sektorin e bujqësisë duhet të adresohen çështjet në vijim: pengesat nga këndi i ofertës; diversifikimi dhe proceset që shtojnë vlerën; dhe qasja e participimi në treg. Vëmendje do t'i kushtohet secilit nga këto dimensione.

#### *Kufizimet në anën e ofertës*

Një program i integruar i "masave të lidhura me ofertën" do të mund të zhvillohet. Këto masa mund të kenë dy objektiva kryesore për trajtimin e kufizimeve në anën e ofertës që janë kritike për:

- Krijimin e nxitjeve më të mëdha për të inkurajuar investimet në sektorin e bujqësisë, dhe për të përmirësuar produktivitetin dhe eksportet në sektorin e bujqësisë; dhe

---

20 Ky seksion kryesisht bazohet në UNCTAD (2008), Export Performance Following Trade Liberalization: Some Patterns and Policy Perspectives, in Economic Development in Africa Series: Geneva.

- Rritjen e konkurrueshmërisë së eksporteve bujqësore kosovare përballë atyre të ekonomive në tranzicion.

Rrjedhimisht Programi duhet të ketë këto komponentë:

*[i] Një pako stimuluese* - Një pako gjithëpërfshirëse fiskale dhe stimulimesh të tjera duhet të zhvillohen për investitorë në sektorin e bujqësisë. Për shembull, mund të ofrohen stimuj dhe lehtësira më të mëdha për produktet dinamike me elasticitet të lartë të ardhurave që synojnë tregjet e reja siç janë produktet e sektorit të hortikulturës dhe ushqimi i përpunuar. Në lidhje me këtë, duhen të merren hapat në vijim:

- Themelimi i një programi për subvencione të inputeve, hartuar me kujdes dhe që ka në shënjestër grupet specifike për të përmirësuar produktivitetin në sektorin e bujqësisë;
- Përmirësimi i qasjes në kredi duke rritur efikasitetin e sektorit financiar, përfshirë zvogëlimin e segmentimit midis sektorëve formal dhe joformal, dhe përmirësimin e bashkëveprimeve midis institucioneve financiare dhe sektorit privat (shih diskutimin më poshtë);
- Themelimi i fondit të posaçëm për zhvillim të eksportit dhe investimeve për të ofruar resurse financiare në mbështetje të ndërmarrjeve biznesore në bujqësi.

*[ii] Përmirësimi i produktivitetit* – Qeveria e Kosovës, mbase në bashkëpunim me sektorin privat, do të rrisë nivelin e investimeve në teknologji, infrastrukturë (rrugë, objekte të ujitjes dhe magazina për deponimin e korrjeve), shërbime shtesë, furnizimin me lëndë të para, si dhe kërkim e zhvillim për të përmirësuar produktivitetin dhe cilësinë e fermave të vogla. Duhet gjithashtu të përmirësohet sistemi i marketingut. Në mënyrë të veçantë, rritja e produktivitet dhe ngritja e

ofertës bujqësore mund të arrihet nëpërmjet veprimeve në vijim:

- Dizajnimi dhe implementimi i politikave të njohura si "kuti e gjelbër", për të mbështetur veçanërisht fermerët e varfër në zonat e largëta rurale (shih më poshtë kutinë për sqarimin e masave në fjalë).
- Sigurimi i objekteve shëndetësore, të ujësjellësit dhe arsimore si mekanizma për përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të jetës në pjesët rurale.

Kutia 4: Politikat "kutia e gjelbër"<sup>1</sup>

*OBT jep shpjegimin në vijim për politikat e "kutisë së gjelbër":*

*"Kutia e gjelbër është definuar në Aneksin 2 (mbështetja vendore: Bazat për përjashtim nga obligimi për reduktim) të Marrëveshjes mbi Sektorin e Bujqësisë. Në mënyrë që të kualifikohen, subvencionet e kutisë së gjelbër nuk duhet të çrregullojnë tregtinë, ose më së shumti të shkaktojnë çrregullime minimale (paragrafi 1). Ato duhet të jenë të financuara nga qeveria (jo duke i ngarkuar konsumatorët me çmime më të larta) dhe nuk guxojnë të përfshijnë mbështetje të çmimeve.*

*Ato jenë programe që nuk synojnë produkte të specifike, dhe përfshijnë mbështetje të drejtpërdrejtë në të ardhura për fermerët që nuk janë të lidhur me (janë "të ndarë" nga) nivelet aktuale të prodhimit ose çmimeve. Ato përfshijnë gjithashtu mbrojtjen e mjedisit dhe programet e zhvillimit rajonal. Prandaj, subvencionet në kontekst të "Kutisë së gjelbër" lejohen pa kufizime, me kusht që ato të jenë në përputhje me kriteret e politikave të veçanta të përcaktuara në Aneksin 2"*

1 Në terminologjinë OBT, në përgjithësi subvencionet identifikohen me anë të "kutive" të cilave u janë dhënë ngjyrat e semaforit: gjelbër (e lejuar), portokall (ngadalëso – d.m.th. të redukohen), e kuqe (e ndaluar). Pasi që në bujqësi gjërat janë më të ndërlikuara Marrëveshja e Bujqësisë nuk ka kuti të kuqe.

*Burimi:* [http://www.wto.org/english/tratop\\_e/agric\\_e/agboxes\\_e.htm](http://www.wto.org/english/tratop_e/agric_e/agboxes_e.htm)  
(qasur më: 8 qershor 2009)

### *Diversifikimi dhe shtimi i vlerës*

Qeveria e Kosovës duhet të zhvillojë programe që promovojnë diversifikimin drejt produkteve me vlerë të shtuar më të lartë në bujqësi. Këto do t'i mundësojnë Kosovës që të rritë përfitimet e saj nga prodhimi bujqësor dhe tregtia. Kjo gjithashtu do të mundësojë që vendi të zvogëlojë rrezikun nga paqëndrueshmëria e çmimeve të mallrave. Disa mundësi janë si në vijim:

- APIK-u në bashkëpunim me shoqatat relevante të biznesit duhet të lansoj programet për të mbledhur dhe shpërndarë informatat e tregut tek prodhuesit;
- Të themelohet "fondi i diversifikimit" me mbështetjen e partnerëve zhvillimor (d.m.th. komunitetin e donatorëve).

Programet për promovimin e depërtimit në treg dhe përmirësimi i qasjes në treg gjithashtu do të merren në konsiderim.

### *Qasja dhe pjesëmarrja në treg*<sup>21</sup>

Kosova duhet të rritë pjesëmarrjen e saj në rrjetat globale të

---

21 është plotësim i diskutimit të përgjithshëm të mësipërm mbi qasjen në treg, si dhe është një shtesë për bujqësinë.

vlerës që të jetë në gjendje që t'i qaset tregjeve të vendeve të zhvilluara dhe ekonomive në zhvillim. Pjesëmarrja në këto rrjete u jep prodhuesve qasje në informatat mbi tregjet dhe u mundëson blerësve që të marrin informata mbi furnizuesit, dhe rrisin besimin në ta. Për produkte specifike, megjithatë, hyrja e prodhuesve, përpunuesve dhe tregtarëve në rrjetat e vlerës varet nga karakteristikat e produktit, kërkesat teknike, strukturat e tregut dhe organizimi i tregtisë.

Faktori përcaktues në hyrjen në treg është kapaciteti që të avancojë produktet dhe të prodhojë sipas standardeve specifike në lidhje me kualitetin, shëndetin dhe standardeve të ambientit, si dhe preferencave dhe shijeve të konsumatorit. Pikërisht për shkak të këtyre kufizimeve, produktet tona nuk kanë qenë në gjendje të depërtojnë në tregjet e BE-së. Me këtë në mendje, duhet të konsiderohet si në vijim:

MTI, në bashkëpunim me shoqatat e biznesit, do të themelojë programet për ngritje të kapaciteteve që të ndihmojë në përmbushjen e standardeve tregtare;

Duhet të themelohen byro informative që të japin informata mbi kërkesat për pjesëmarrje në rrjetat globale të vlerës, që të promovojë shfrytëzimin e mundësive në tregjet dinamike.

### *3.2.1.2 Eksportet industriale*

Tri veprime të ndërlidhura mund të propozohen për forcimin e kapacitetit produktiv të sektorit industrial: rritja e aftësisë konkurruese të firmave prodhuese, ndihma në ekspansionin e madhësisë së firmave, dhe lehtësimi i qasjes së firmave në faktorët e prodhimit me qëllim të investimit dhe rritjes.

### *Rritja e konkurrueshmërisë së firmës*

Efikasiteti është faktori më i rëndësishëm që përcakton konkurrueshmërinë e firmës dhe pjesëmarrjen në tregjet e eksportit. Në Kosovë, nevoja për të rritur aftësinë konkurruese përmes riparimit të infrastrukturës së prodhimit aktual dhe eksportit është e një rëndësie të veçantë. Konkurrueshmëria duhet të ndërtohet në nivel të ekonomisë nacionale dhe të firmës.

*[i] Konkurrueshmëria në nivel të ekonomisë nacionale – Për ndërtimin e konkurrueshmërisë në nivelin e ekonomisë duhet të mirren disa hapa:*

- Përmirësimin e infrastrukturës bazë prodhuese për ta bërë prodhimtarinë më të sigurt;
- Inkurajimin e infrastrukturës së tregtisë ndër-kufitare; administrata joefektive doganore është pengesë e lëvizjes së lirë të mallrave në rajon. Efektiviteti më i madh këtij institucioni do të ulte koston e transakcioneve të tregtisë së jashtme.

*Konkurrueshmëria në nivel të firmës – Konkurrueshmëria e firmës për eksport mund të përmirësohet përmes tri kanaleve:*

- Rritja e produktivitetit të punës përmes promovimit të trajnimit profesional, trajnimin gjatë punës dhe shkëmbimin e praktikave më të mira në proceset e prodhimit;
- Ndërtimi i aftësive teknologjike në nivel të firmës me qëllim që ato të mund të modernizojnë teknologjinë për të përmbushur standardet dhe normat e tjera që kërkohen nga sistemi aktual tregtar si dhe tregjet për eksport;

- Krijimi i stimujve të përshtatshëm për të orientuar prodhimtarinë përpunuese drejt tregut për eksport në mënyrë që të përfitojnë nga efikasitetit më i lartë dhe përparësive tjera që rrjedhin nga eksporti. Kjo mund të bëhet përmes rritjes së efikasitetit të aktiviteteve të APIK-ut për promovim të eksportit. Kjo e fundit është e ngarkuar me sigurimin e informatave mbi shansat që ofrojnë tregjet, standardet dhe kërkesat e tjera për eksportit.

### *Nevoja për firma të mëdha prodhuese*

Siç kemi vënë në dukje më parë, struktura e firmave sipas madhësisë në sektorin industrial dhe atë të prodhimit në Kosovë anon shumë kah firmat shumë të vogla. Një prani më e madhe e firmave të mëdha në ekonomi mund të bëhet e mundur përmes: (i) inkurajimit të krijimit të firmave të mëdha prodhuese që nga fillimi; (ii) krijimi i një mjedisi të përshtatshëm që ndihmon firmat e reja të vogla të rriten dhe të bëhen të mëdha. Në këtë kontekst, duhet të përqipemi siç vijon:

- Inkurajimi i IHD-ve në sektorin e prodhimit;
- Identifikimi dhe inkurajimi i ndërmarrësve kosovar që janë të aftë për të mobilizuar resurset e nevojshme për themelimin e firmave të mëdha.

### *Lehtësimi i qasjes në kredi për të investuar dhe të nxitur rritjen e firmës*

Një nga arsyet pse ndërmarrësit kosovar themelojnë firma shumë të vogla mund të jenë kufizimit që kanë në qasje në kapital. Fillimi i aktivitetit mbështetet në resurset vetanake të pronarëve të tyre pasi që ata nuk mund të kenë qasje të

mjaftueshme në kredi ose të rrisin resurset nga tregu i kapitalit. Çështja e madhësisë së firmës në momentin e themelimit nuk do të ishte një çështje për t'u diskutuar po që se firmat do të mundeshin lehtë të kenë qasje në faktorët e prodhimit, veçanërisht në kredi, në mënyrë që të investojë, rriten dhe përfundimisht të arrijnë përmasat e mëdha të nevojshme për të qetë konkurruese në tregjet e eksportit. MTI beson se janë dy fusha kyçe ku duhet fokusuar: lehtësimin e qasjes në kredi dhe forcimin e bashkëveprimeve midis institucioneve financiare dhe sektori privat.

[i] Qasja në kredi - Qasja në kredi është ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikon në performancën e firmës. Megjithatë, duket se kostot e transaksioneve për procesimin e aplikacioneve për kredi të firmave të vogla janë thjesht shumë të larta. Ky problem mund të lehtësohet në dy mënyra:

Zhvillimi dhe mbështetja e institucioneve kreditore që janë më shumë të adaptuara nevojave të firmave të vogla. Këto institucione mund të luajnë një rol në një afat të shkurtë, por është e dyshimtë nëse ato janë zgjidhja më e mirë afatgjate për problemin e kredive, duke marrë parasysh resurset e kufizuara të tyre. Prandaj, modernizimi i mëtejshëm i sektorit financiar duhet të jetë objektivë afatgjatë për të krijuar një sektor më të fuqishëm financiar.

Krijimi i byrove për informim rreth kreditimit mund të ngushtojë, dhe atë me kosto të ulët, asimetrinë informative në mes aplikantëve për kredi të vogla dhe institucioneve financiare. Këto institucione mbledhin Informacione mbi aftësinë Kreditore të aplikantëve potencial dhe shkëmbejnë ato me huadhënësit me kosto relativisht të ulët. Kjo mund të

jetë pjesë e një programi qeveritar i cili synon financimin e një pjesë substanciale të risk premiumeve për firma më të vogla (shih më poshtë).

[ii] Krijimi i një kornize të bashkëveprimit në mes të institucioneve financiare dhe sektorit privat - Kjo do të mund të ndihmojë të mbulojë hendekun informativ midis kërkesës dhe ofertës për kredi. Në lidhje me këtë:

- Duhet të organizohen kontakte të rregullta në mes të përfaqësuesve të sektorit privat dhe të sistemit bankar, mundësisht nëpërmjet odave ekonomike, për të shkëmbyer ide mbi çështjet me interes të ndërsjellët.
- Bankat komerciale mund të shqyrtojnë hapjen në filijalat e tyre të sporteleve të posaqme dedikuar për ndërmarrjet të vogla, pasi që kjo është eksperimentuar me sukses në disa vende. Këto sportele shkojnë përtej funksioneve tradicionale të vlerësimit të huave. Ato gjithashtu ndihmojnë ndërmarrjet e vogla të përgatisin aplikacionet e tyre për hua dhe ofrojnë disa trajnime në menaxhimin e projekteve;

Programe edukative dhe kampanja informative duhet të organizohen në baza të rregullta, për të rritur vetëdijen e aktorëve të sektorit privat, veçanërisht të ndërmarrjeve të vogla, mbi mundësitë e ndryshme biznesore në dispozicion të tyre. Ndhma firmave të vogla për të investuar, për t'u rritur dhe participuar në tregjet e eksportit do të jetë e dobishme për të gjithë.

### 3.2.1.3 Çështjet e ndërlidhura

Në këtë kontekst, duhet të diskutohen dy dimensione kryesore: sektori privat dhe investimet e huaja direkte. Sa i përket të parës, përfitimi nga rrjeti global i vlerës në bujqësi dhe prodhimtari nënkupton që zhvillimi i sektorit privat në këta sektorë kalon përmes disa domeneve të politikave, përfshirë përmirësimet në ambientin e përgjithshëm të biznesit dhe zbatimit të kontratave, dhe zhvillimin e ofruesëve të shërbimeve biznesore. Asociacionet e biznesit duhet të formojnë partneritet me Qeverinë për fuqizimin e kontratave, përfshirë arritjen e përmbushjes së standardeve të caktuara. Në mënyrë të ngjashme, shfrytëzimi i plotë i efekteve nga investimet e huaja direkte<sup>22</sup>, posaçërisht sa i përket rritjes së potencialit eksportues të Kosovës, ka implikime gjithëpërfshirëse të politikave.

### **3.2.2 Korniza kohore e politikave zhvillimore të lidhura me tregtinë**

Në vijim janë dhënë disa parametra të përgjithshëm dhe shembuj të caktuar të politikave zhvillimore të lidhura me tregtinë të cilat MTI konsideron se janë të zbatueshme në rastin e Kosovës. Këto politika kërkojnë përpjekje të përbashkëta të aktorëve të ndryshëm të përfshirë në procesin e politikës tregtare. Lista tani është e përgjithësuar por ofron

---

<sup>22</sup> Investimet e huaja direkte janë shumë të rëndësishme për gjenerimin e tregtisë por kjo është një çështje e cila tejkalon këtë detyrë të veçantë, dhe si e tillë duhet të adresohet veçmas në mënyrë më të fokusuar.

një drejtim të përgjithshëm për këtë politikë:

### 3.2.2.1 Politikat afatshkurta

Disa nga masat afatshkurta përfshijnë refondimin dhe përjashtimin nga pagesa e tarifave doganore si dhe skemat për financim të eksportit dhe të stimulimeve. Nga aspekti i politikës zhvillimore të lidhur me tregtinë, ekzistojnë mundësi për përdorimin e zbritjes për amortizim të përshpejtuar si dhe të mekanizmave tjerë, p.sh. në politikën industriale. Në mënyrë më specifike, programi do të fokusohet në:

Identifikimin e masave të politikës fiskale dhe industriale për t'i dhënë shtytje eksportit me synim të rritjes së kualitetit dhe kuantitetit të punësimit në afat të shkurtë. Këto masa mund të përfshijnë ide inovative (të bazuara edhe në përvojat e vendeve tjera) për skemat e promovimit të eksportit për sektorët ekzistues, financimin dhe nxitjet e eksportit, dhe opsionet e politikave sektoriale të bujqësisë, industrisë dhe shërbimeve siç është zbritja e amortizimit të përshpejtuar (për industrinë). Një platformë e makro politikave lidhur me tregtinë e cila do të ishte më e favorshme për promovimin e eksportit si dhe të komplementaritetit të tij (siç janë politikat alternative të menaxhimit të kërkesës) duhet gjithashtu të konsiderohet. Këto alternativa makro synojnë përmirësimin e konkurrueshmërisë së sektorit të jashtëm.

Masat fiskale dhe masat e tjera për menaxhimin e importeve me synim të promovimit të mëtejshëm të eksportit. Kjo duhet të përfshijë analizat dhe rivlerësimin e përvojave me rikthimin të tarifave doganore bazuar në përvojat e vendeve

tjera. Kjo duhet gjithashtu të përfshijë mjete inovative siç janë linjat kreditore të lehta për t'iu qasur, të cilat lehtësojnë transaksionet ndërmjet blerësve ndërkombëtarë dhe shitësve.

### *3.2.2.2 Politikat afatmesme*

Kosova duhet të tejkaloj disa çështje të rëndësishme të lidhura me infrastrukturën e tregtisë (lehtësimi i tregtisë) dhe koston e të bërit biznes. Përderisa disa nga çështjet infrastrukturore mund adresohen vetëm në afat të gjatë, është vlerësim i përgjithshëm brenda MTI-së se shumica e këtyre çështjeve mund të adresohen brenda një periudhe afatmesme kohore. Rrjedhimisht, disa veprime të propozuara mund të përfshijnë:

- Identifikimin e masave për krijimin e një fushe të veprimit të barabartë për aktorët në treg, si për eksportuesit komercial ashtu edhe ata industrial në Kosovë. Kjo përfshin identifikimin dhe propozimet për eliminimin e pengesave ekzistuese dhe atyre të ardhshme për bërjen biznes të eksportuesëve Kosovar (në të gjithë sektorët e këmbimit) konkurrent në tregun e jashtëm. Kjo duhet të fokusohet jo vetëm në eksport dhe eksportues por edhe në import në përgjithësi. Qasja më e lehtë në lëndët e para dhe në të mirat kapitale të ndërmjeme të importuara është esenciale.<sup>23</sup> Kjo gjithashtu do të ndihmoj lehtësimin e presioneve të mundshme në sektorët vendorë (të tregtueshëm dhe jo të tregtueshëm) pas anëtarësimit në OBT. Kjo kërkon identifikimin e koston së kapitalit (dhe koston së bërjes biznes në përgjithësi) sipas kërkesave të regjimit tregtar dhe përfshirjen e masave për zvogëlimin e

---

23 Trendi aktual në Kosovë sa i përket rritjes së pjesës së lëndëve të para dhe të mirave të ndërmjeme të importuara në të mirat finale është i kënaqshëm (shiko diskutimin në lidhje me Figurën 3).

kostos së bërjes biznes në Kosovë. Njësoj me rëndësi, kjo duhet t'i adresojë pyetjet që kanë të bëjnë me infrastrukturën tregtare, prodhuese dhe financiare (të përgjithshme dhe sektoriale) dhe të identifikoj fushat në të cilat vendi ka mungesë të infrastrukturës si dhe të vij me propozime operacionale. Në fushën e sektorit financiar, rëndësia e zhvillimit të tregut afatgjatë të kapitalit për përmirësimin e konkurrueshmërisë në sektorët kyq dhe lehtësimin të investimeve shtesë (për modernizim) është shumë e madhe. Më tutje, duhet të adresohen çështjet e lidhura me qasjen në kredi të NVM-ve të orientuara në eksport. Ristrukturimi në disa nga këta sektorë do të jetë i domosdoshëm dhe kjo mund të bazohet në përvojën e vendeve të tjera. Aktivitetet gjithashtu duhet të prekin mbi çështjet e kontrollit të kualitetit dhe masave Sanitare dhe Fitosanitare dhe qështjet e barrierave teknike në tregti, si dhe çështjet që janë të lidhura me lehtësimin e tregtisë; mekanizmave për krijimin e nxitjeve apo stimujve, transferit të duhur teknologjik si dhe të praktikave më të mira. Transferi i duhur teknologjik apo gjenerimi teknologjik është posaçërisht i rëndësishme si aktivitet afatmesëm. Lloji i transferit teknologjik i nevojshëm për rritjen e konkurrueshmërisë në Kosovë do të duhet gjithashtu të marrë parasysh brengat për krijimin e mundësive të barabarta dhe të qëndrueshme të punësimit. Lloji i transferit teknologjik dhe/ose kërkesat për hulumtim dhe zhvillim gjithashtu do të përcaktohen sipas nevojave dhe strukturës sektoriale.<sup>24</sup>

- Identifikimi i tregjeve të reja dhe atyre në tranzicion për eksportet Kosovare. Ky aktivitet do të duhet të përfshij identifikimin e modeleve të reja dhe atyre në tranzicion të marrëveshjeve tregtare, përfshirë hulumtimin e opsioneve

---

24 Për shembull, në varësi të sektorëve të konsumit dhe jo konsumit apo të produkteve të bazuara në resurse.

regjionale dhe bilaterale dhe tregjeve për promovimin afatshkurtër dhe afatmesëm të eksportit. Mundësitë e politikave të ndryshme tregtare (afatmesme) që varen nga mjedisi rajonal dhe ai i vendit gjithashtu duhet të hulumtohen. Përfundimisht, duhet të eksploroehen mundësitë për marketingun e jashtëm dhe aktivitetet për ndërtim të imazhit, siç janë përfaqësitë për shitje me pakicë, përfaqësitë tregtare dhe qendrat e biznesit.

### *3.2.2.3 Politikat afatgjata*

Si shtesë të këtyre aktiviteteve afatshkurta dhe afatmesme, ekziston nevoja për formulimin e opsioneve të politikave të cilat do të adresonin problemet përgjatë një periudhe afatgjate. Aktivitetet afatgjata duhet kryesisht të fokusohen në aspektet e investimeve vendore të orientuara në eksport (përmes investimeve të përbashkëta të cilat garantojnë transferin e duhur teknologjik në varshmëri nga sektori ekonomik). Gjithashtu duke pasur parasysh përparësitë e mëdha demografike, duhet të eksploroehen edhe mundësitë siç është transferimi i një pjese të aktivitetit te firmat tjera të cilat mund ta realizojnë aktivitetin/et e caktuar/a në mënyrë më eficiente (process ky i njohur si outsourcing). Disa nga hapat e propozuar përfshijnë:

Identifikimin dhe aplikimin e skemave për rritje të efikasitetit (si ato të marketingut dhe prodhuese) në grupet themelore të sektorëve (ekzistues) të eksportit. Ky aktivitet i politikave do të kërkonte përdorimin e vlerësimit të nevojave sektoriale dhe nën-sektoriale dhe zhvillimin e opsioneve të politikave në nivelin mikro. Gjithashtu duhet të ketë fokus të qartë NVM-të. Kjo do të përfshinte poashtu propozimet mbi skemat trajnuese

për ndërmarrësit, menaxherët dhe punëtorët (si mbi OBT-në gjithashtu edhe mbi çështjet specifike sektoriale).

Identifikimi i sektorëve zhvillimorë shtesë me qëllim të diversifikimit të eksportit të qëndrueshëm dhe të orientuar në punësim, i cili si rrjedhojë kërkon identifikimin e sektorëve ku vendi ka përparësi dinamike konkurruese dhe krahasuese. Puna aktuale e APIK-ut duhet të përkrahet dhe zgjerohet me një program i cili do të bëjë analiza të thella të përparësive dinamike (dhe statike) konkurruese dhe krahasuese dhe identifikoj sektorët të cilët kanë potencial dhe rritje të qëndrueshme të eksportit. Praktika duhet po ashtu të krijoj masa për krijimin dhe implementimin e skemave nxitëse dhe mbrojtëse në këto fusha ashtu që sektorët e identifikuar të mund të operacionalizohen shpejtë dhe të jenë të gatshëm për t'u ballafaquar me konkurrencën e jashtme (përfshirë skemat efikase të marketingut dhe produktivitetit, të modeluara sipas përvojave të vendeve tjera). Skemat stimuluese duhet të jenë selektive dhe saktësisht të precizuara në kohë sipas specifikave sektoriale. Skemat e trajnimit për punëtorë, (të cilat gjithashtu duhet të ngriten në afat të mesëm), do të përfshijnë skemat trajnuese profesionale për punëtorët (e punësuar dhe potencial) në fushat alternative të diversifikimit të eksportit. Zhvillimi dhe aplikimi i trajnimit dhe ritrajnimit dhe skemat për përmirësimin e prodhimit dhe efikasitetit si për formimin e kapitalit ekzistues ashtu edhe për industrinë e reja duhet të zënë vend si pjesë e aktiviteteve afatgjata të politikave. Më tutje, pilotimi i sektorëve potencial dhe skemave nxitëse po ashtu duhet të zërë vend.

### **3.3. Ndryshimet institucionale për politikë tregtare të orientuar kah zhvillimi<sup>25</sup>**

Bërja e politikave tregtare të orientuara kah zhvillimi, të diskutuara më lart, kërkon ndërmarrjen e hapave të caktuar. Së pari, opsionet alternative të politikës tregtare duhet të peshohen ndaj njëri-tjetrit. Kjo kërkon vlerësim ex ante të ndikimit të tyre në zhvillimin human si dhe kompatibilitetin e tyre me politikat zhvillimore të lidhura me tregtinë. Pas identifikimit të politikës tregtare më optimale, inkorporimi i tyre në strategjinë kombëtare të zhvillimit është i nevojshëm. Kjo do të thotë që procesi mbulon vet MTI si udhëheqëse ashtu edhe institucionet tjera relevante. Implementimi i politikës tregtare vjen më pas. Implementimi dhe rezultatet e politikës tregtare duhet të vëzhgohen mirë gjatë tërë procesit të kalimit nga politika tregtare deri te zhvillimet e faktorit njeri dhe prapa. Së fundi, një vlerësim ex-post duhet të udhëhiqet dhe interpretohet vetëm për të përshtatur hapat e ardhshëm të politikës tregtare. Prandaj, formulimi i procesit të politikës tregtare të orientuar kah zhvillimi mund të përmbledhet në gjashtë hapat në vijim (disa nga të cilët në raste të caktuara mund të mbulojnë çështje të njëjta):

1. Formulimi dhe interpretimi;
2. Vlerësimi (ex-ante);
3. Koordinimi (përfshirë inkorporimin në strategjitë

---

<sup>25</sup> Kjo pjesë përmbledh rezultatet e dy raporteve të përpiluara nga Keklik dhe Gashi në vitin 2009 të cilat planifikojnë asetet e kapaciteteve dhe nevojave të institucioneve të Kosovës në lidhje me analizën dhe formulimin e politikave të tregtisë dhe efektet e tyre në zvogëlimin e varfërisë dhe zhvillimit human, si dhe për të interpretuar, zbatuar dhe negociuar marrëveshjet tregtare. Në bazë të vlerësimit të nevojave është gjeneruar një Plan Zhvillimor i Kapaciteteve. Raportet ofrojnë njohuri shtesë dhe rezultate mbi zhvillimi human dhe institucional në institucionet e Kosovë të lidhura me tregtinë. Raportet janë porositur nga UNDP.

- kombëtare të zhvillimit);
- 4. Implementimi;
- 5. Vlerësimi (ex-post);
- 6. Përshtatjen dhe korrektimin e politikës.

Ky proces kërkon një strukturë të qartë të institucioneve (tradicionale dhe jo-tradicionale) si brenda ashtu edhe jashtë MTI, si shtesë e institucioneve dhe agjencive që janë kyçe për tregtinë dhe rrjedhën e investimeve brenda dhe jashtë vendit. Zhvillimi dhe integriteti institucional është i nevojshëm për bartjen dhe zbatimin e kësaj strukture *konceptuale* të politikës zhvillimore në rastet *praktike* siç janë negociatat me OBT-në dhe CEFTA dhe marrëveshjet e BE-së në rastin e Kosovës.

Institucionet e lidhura me tregtinë në Kosovë në raste të caktuara kanë kapacitete teknike të mira, por kryesisht janë këta individë. Megjithatë, kjo është individuale dhe e pa koordinuar, dhe kështu si kapacitet është i shpërndarë. Veç kësaj, kapaciteti teknik nuk është i drejtuar kah cikli i politikës tregtare të orientuar kah zhvillimi. Ekziston nevoja për mekanizma koordinues si në MTI ashtu edhe në sistemin si tërësi. Kjo gjithashtu duhet të riorientohet kah qëllimet zhvillimore në një mënyrë analitike. Në këtë kontekst, MTI propozon tri fusha për intervenim:

1. MTI do të analizoj mundësinë e ristrukturimit që të reflektoj në mënyrë më gjithëpërfshirëse orientimin zhvillimor dhe qëndrueshmërinë në zhvillimin e politikës tregtare. Institucionet tradicionale dhe jo-tradicionale përfshirë proceset dhe sistemet biznesore do të operacionalizohen me tutje. MTI do të kërkoj mënyra që të ngrisë nivelin e saj operacional me kapacitete shtesë humane, financiare dhe

teknike në mënyrë që të ketë një zhvillim të qëndrueshëm institucional.

2. Ristrukturimi institucional duhet të forcojë në veçanti koordinimin midis MTI-së dhe akterëve relevant në sistemin e përgjithshëm tregtar në Kosovë. Koordinimi nuk mund të arrihet nëse nuk ka asgjë për t'u koordinuar. Kjo do të thotë se sistemi duhet të identifikoj dhe vlerësoj vizionin e tij në mënyrë më specifike dhe ta krahasoj atë rregullisht kundrejt realitetit.
3. Të dhënat që kanë të bëjnë me tregtinë dhe institucionet e dijës duhet të koordinohen dhe aktivitetet e tyre duhet të jenë konsistente dhe koherente në sistem. MTI konsideron se ESK duhet jetë burimi i vetëm për të dhënat dhe analizat tregtare.